ANKESË

Drejtuar: Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), Prishtinë
Kopje: Ministrisë së Mbrojtjes – Departamentit të Prokurimit dhe Kontratave

Ankesë sipas neneve 109 dhe 111 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-092 (në tekstin e mëtejmë: LPP), kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398) të datës 13.11.2026 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi 6398).

I. Palët dhe aktiviteti i prokurimit

Ankuesi (neni 111.1.1 LPP)	ARDITI TOURS SH.P.K., NUI 811049255, rr. Ahmet Kaqiku, 70000 Ferizaj; tel. 049 627 777; e-mail: arditi tours@hotmail.com; përfaqësues: Albert Fazlija
Autoriteti kontraktues (neni 111.1.2 LPP)	Ministria e Mbrojtjes, Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave
Aktiviteti (neni 111.1.3 LPP)	"Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë", Nr. i prokurimit 217-26-8174-2-1-1, Nr. i brendshëm 217/26/094/211; **Pjesa 3 – Kazerma Mitrovicë dhe Istog**
Njoftimi për kontratë	Publikuar më 24.09.2026
Akti i kontestuar	Vendimi i AK Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398), 13.11.2026, me të cilin u refuzua kërkesa për rishqyrtim e ankuesit dhe u vërtetua Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 06.11.2026 për Pjesën 3
OE i rekomanduar	Grupi i operatorëve ekonomikë DITA TRAVEL SH.P.K. (lider, NUI 811944132) – JONI TRAVEL SH.P.K. (anëtar, NUI 811014779)

Statusi i palës së interesuar (neni 111.1.5 LPP). Ankuesi ka dorëzuar ofertë për Pjesën 3 dhe ka interes të drejtpërdrejtë për dhënien e kontratës. Ankuesi ka shteruar mjetin paraprak: ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim më 11.11.2026, të cilën AK e ka refuzuar me vendimin e kontestuar.

Afati (neni 109 LPP). Vendimi i AK-së është marrë më 13.11.2026. Ankesa parashtrohet brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh, i cili skadon më 23.11.2026.

Kopja për AK-në (neni 111.2 LPP). Ankuesi, njëkohësisht me dorëzimin në OSHP, i dërgon një kopje të kësaj ankese Autoritetit Kontraktues.

II. Objekti i ankesës

Ankesa e kundërshton Vendimin 6398 në tërësi, për të gjashtë pretendimet e kërkesës për rishqyrtim të datës 11.11.2026: **Pretendimi 1** – Kërkesa 9, përvoja dhe referencat (pikat 1.1–1.7); **Pretendimi 2** – Kërkesa 15, stafi dhe shoferët; **Pretendimi 3** – nënshkruesi i dokumenteve dhe marrëveshja e grupit; **Pretendimet 4 dhe 6** – minibusi 06-281-GG dhe vulat në kontratën e qirasë; **Pretendimi 5** – marrëveshja e grupit, deklarata nën betim dhe licenca e Joni Travel.

Ankuesi nuk ngre pretendime të reja. Të gjitha faktet më poshtë lidhen me pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim. Provat e bashkëngjitura (P-1 deri P-22) janë pjesë e Dosjes së Tenderit, e ofertës së grupit të rekomanduar ose të vendimeve të AK-së; pjesët me gabime janë shënuar me kornizë të kuqe.

Ankuesi nuk kërkon që referencat e kontestuara të verifikohen. Ai kërkon që OSHP të konstatojë se ato **nuk janë të vlefshme** sipas Kërkesës 9 dhe Evidencës 9. Mangësitë duken në vetë

dokumentet e ofertës: kush i ka lëshuar, për cilin operator, për çfarë periudhe dhe me çfarë vlere. Për këtë arsye nuk nevojitet asnjë verifikim i jashtëm dhe oferta nuk mund të plotësohet më (neni 59.2 LPP; pikat 28.1 dhe 29.1 IUT).

Shkelja i shkakton ankuesit dëm të drejtpërdrejtë: kontrata për Pjesën 3 i është dhënë një ofertuesi, oferta e të cilit nuk është e përgjegjshme.

III. Dispozitat e shkelura (neni 111.1.7 LPP)

Akti	Dispozita	Përmbajtja
LPP	Neni 7.1	"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente."
LPP	Neni 59.2	"…Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues."
LPP	Neni 59.4	"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."
LPP	Neni 69.4.2 (i) dhe (ii)	Për autoritet publik, dëshmi është "kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik"; për blerës privat, dokumenti i nënshkruar nga blerësi "dhe evidentimi i sigurimit të tillë".
LPP	Neni 71.4	Kërkesat për aftësi zbatohen ndaj grupit si tërësi, d.m.th. vetëm për përvojën e anëtarëve të grupit.
LPP	Nenet 108/A.9 dhe 108/A.12	Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim duhet të arsyetohet dhe vendimi i AK-së duhet të jetë i arsyetuar.
LPP	Nenet 105.2.8 dhe 105.2.10	OSHP mund ta detyrojë AK-në të anulojë vendimin dhe të korrigjojë shkeljen.
RrPP (001/2022, ndryshuar me 002/2024)	Neni 25.13	OE dëshmon se "në të kaluarën **ka përfunduar** kontrata të një natyre të ngjajshme".
RrPP	Neni 25.16 (i) dhe (ii)	Certifikata "e lëshuar ose e bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë"; "të gjitha këto dëshmi duhet të kenë vlerën e realizuar"; për blerës privat, dëshmi "të pagesës nga banka".
RrPP	Neni 26.14	Nëse anëtari i grupit ka ofruar të dhëna të rreme, AK "do të eliminojë tenderin e grupit".
RrPP	Nenet 70.9, 72A.4, 73A.1 (c) dhe 75.3 (pikat 1 dhe 3)	Shërbimet pranohen nga menaxheri i kontratës me raport përfundimtar; vetëm me këtë raport "obligimet e palëve kontraktuese konsiderohen të përfunduara". Zyrtari përgjegjës i prokurimit nënshkruan kontratën, por e ka të ndaluar të nënshkruajë përfundimin e projektit; atë e nënshkruan njësia pranuese ose menaxheri i projektit.
Dosja e Tenderit	Kërkesa 9 dhe Evidenca 9	Kontrata të përfunduara me sukses "(jo në realizim e sipër)"; minimumi 650,000.00 € për të gjitha pjesët; referenca nga "autoritetet përkatëse" me numër dhe vlerë kontrate; për blerësit privatë, dëshmi bankare; "Vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë."
Dosja e Tenderit, IUT	Pikat 27.2 (c), 28.1, 29.1	Sqarime vetëm për dokumente "ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit"; tenderi jo i përgjegjshëm "nuk mund të bëhet i tillë … duke e korrigjuar".

Për Pretendimet 2–6 janë shkelur edhe: Kërkesa 14 dhe Evidenca 14 a) (kontratat e qirasë “të nënshkruara nga të dy palët”); Kërkesa 15 dhe Evidenca 15 a) (stafi me profesion dhe përvojë pune, shoferë me kategori D të vlefshme); Evidenca 01 dhe Aneksi 2 (deklarata e nënshkruar); pika 8 e Informatave shtesë të FDT (autorizimi për nënshkrim); Aneksi 1 (licencimi) dhe Aneksi 7 (marrëveshja e grupit); neni 71 i LPP.

IV.A Faktet dhe arsyetimi juridik – Pretendimi 1: referencat nuk janë të vlefshme (neni 111.1.6 LPP)

1. Kur vlen një referencë

Kërkesa 9 kërkon që ofertuesi të ketë “përfunduar me sukses (jo në realizim e sipër)” kontrata të ngjashme gjatë tri viteve para publikimit të njoftimit (P-1). Njoftimi është publikuar më 24.09.2026, prandaj periudha është **24.09.2023 – 24.09.2026**.

Grupi ka ofertuar për të katër Pjesët (P-2). Sipas Kërkesës 9, kur OE oferton për më shumë pjesë, “kërkesa minimale që duhet të përmbushet është shuma më e lartë e kërkuar për pjesët për të cilat konkurron” (“Për të gjitha pjesët › minimumi 650,000.00 €”). Sipas kësaj dhe nenit 71.4 të LPP, grupi duhet të dëshmojë **të paktën 650,000.00 €**. AK e ka pranuar këtë prag në Vendimin 6398 (P-13). Edhe sikur të zbatohej vetëm pragu i Pjesës 3, 625,000.00 €, përfundimi nuk ndryshon (shih Seksionin V).

Sipas Evidencës 9 b), nenit 69.4.2 të LPP dhe neneve 25.13 e 25.16 të RrPP, një referencë llogaritet vetëm nëse plotëson **të gjitha** kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Është lëshuar ose bashkënënshkruar nga autoriteti që ka lidhur kontratën (neni 69.4.2 (i) LPP; neni 25.16 (i) RrPP).

2. Vërteton përvojën e vetë anëtarit të grupit, jo të një operatori tjetër (neni 71.4 LPP).

3. Kontrata është përfunduar brenda periudhës 24.09.2023 – 24.09.2026 (Kërkesa 9; neni 25.13 RrPP). Për shërbimet, kontrata quhet e përfunduar vetëm me raportin përfundimtar të menaxherit të kontratës (nenet 70.9, 72A.4, 73A.1 (c) dhe 75.3 RrPP).

4. Përmban numrin e kontratës dhe vlerën e realizuar (Evidenca 9 b); neni 25.16 (i) RrPP). Për blerësit privatë duhet edhe dëshmia bankare për atë vlerë (neni 25.16 (ii) RrPP).

Referenca që nuk plotëson njërin prej këtyre kushteve nuk merret në konsideratë: “Vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë” (Evidenca 9).

PROVA P-1 – Dosja e Tenderit: Kërkesa 09 dhe Evidenca 09

Çka tregon: Kërkesa 09 kërkon kontrata të përfunduara me sukses “(jo në realizim e sipër)”. Pragu për ofertuesin në të gjitha pjesët është 650,000.00 €. Evidenca 09 përfundon: “Vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë.”

Dispozita: Kërkesa 9 dhe Evidenca 9 e FDT; neni 59.4 i LPP; pikat 27.2 dhe 29.1 të IUT.

		përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite, do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar.	
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 09 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses (jo në realizim e sipër) kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, jo më pak se Pjesa 1 650,000.00€ Pjesa 2 550,000.00€ Pjesa 3 625,000.00€ Pjesa 4 570,000.00€ Në rast se Operatori Ekonomik oferton për një ose më shumë pjesë (lote), kërkesa minimale që duhet të përmbushet është shuma më e lartë e kërkuar për pjesët për të cilat konkurron. Shembuj** **• Për Pjesën 1 dhe 2 › minimumi 650,000.00 €** **• Për Pjesën 2 dhe 3 › minimumi 625,000.00 €** **Për të gjitha pjesët › minimumi 650,000.00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Evidenca 9 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri (3) viteve të fundit, të nënshkruar dhe vulosur nga OE; b) Referencat ose raportet e pranimit ose fletëpranimet teknike, në kopje të nënshkruara dhe vulosura nga autoritetet përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë • numrin e kontratës prokurimit; • vlerën e kontratës; • Për kontratat e realizuara për autoritete publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Kosovës, duhet të dorëzohen referencë positive, fletpranim apo raport pranimi teknik të lëshuara nga autoriteti përkatës, ku specifikohet edhe vlera e kontratës. • Për referencat nga institucionet private, duhet të dorëzohet edhe dëshmi e qarkullimit bankar për vlerën përkatëse. • Vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë.**

Dosja e Tenderit, Seksioni II (FDT) – Kërkesa 09 dhe Evidenca 09.

PROVA P-2 – Formulari i tenderit: grupi ka ofertuar për të katër Pjesët

Çka tregon: Grupi Dita Travel – Joni Travel ka ofertuar për Pjesët 1, 2, 3 dhe 4. Sipas Kërkesës 9, pragu i tij është 650,000.00 €.

Dispozita: Kërkesa 9 e FDT (“Për të gjitha pjesët › minimumi 650,000.00 €”); neni 71.4 i LPP.

Prokurimi: 217-26-8174-2-1-1

Nr i brendshëm:

Titulli: Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomazotin Pjesa 2 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjilan dhe Ferizaj. Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog Pjesa 4 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjakovë dhe Suharekë

1	Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomazotin
2	Pjesa 2 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjilan dhe Ferizaj.
3	Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog
4	Pjesa 4 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjakovë dhe Suharekë

Kodi i tenderit: 217-26-8174-2-1-1

Data: 21.10.2026

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	3-- RAPORTI FINANCIAR.rar
2.	4--DOKUMENTACIONI LEGAL I KOMNIS.rar
3.	6-A- KONTRATA DHE REFERENCA DITA.rar
4.	6--KONTRATA DHE REFERECA.rar
5.	5--STAFI PROFESINAL DHE STAFI TEKNIK SHOFERAT.rar
6.	7--AUTOMJETET AUTOBUSET.rar
7.	2--DEKLRTATA ,SIGURIMI ,EVIDENCAT , MARRVESHJE KONZ.rar
8.	Paramasat lot1-4.rar

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomazotin	LOT 1 PERSHKRIMI I CMIMEVE.pdf
2.	Pjesa 2 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjilan dhe Ferizaj.	LOT 2 PERSHKRIMI I CMIMEVE.pdf
3.	Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma	LOT 3 PERSHKRIMI I CMIMEVE.pdf

Formulari i tenderit i grupit, faqja 1.

2. Vërtetimi për kontratën MASHT 25-6586-2-2-1 nuk vlen – 63,751.00 € (P-5, P-6, P-10)

Faktet. Kontratën e ka lidhur Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHT) me Joni Travel. Për MASHT e ka nënshkruar Xhemajl Buzuku. Sipas nenit 1.4, kontrata vlen 17.09.2025 – 16.09.2026. Kontrata thotë gjithashtu se "Autoriteti kontraktues kryen shërbime vetëm në emër të vet".

Dokumenti i dorëzuar është "Vërtetim për realizimin e kontratës" i datës 15.10.2026. Në krye ka emrin e Qendrës Burimore "Nëna Terezë" në Mitrovicë. E ka nënshkruar Marta Popović, "Direktor Centra", dhe e ka vulosur Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Kosovski Bozhur" në Mitrovicë. Ai thotë se kontrata është nënshkruar më 18.09.2025, se "afati kohor i performancës ka qenë 36 muaj" dhe se vlera e shërbimeve të realizuara "ka arritur shumën prej 63.751.00 €".

Pse nuk vlen:

- **Nuk e ka lëshuar autoriteti kontraktues.** Asnjëra nga këto qendra nuk është palë në kontratë. Neni 69.4.2 (i) i LPP pranon vetëm certifikatë "të lëshuar ose bashkënënshkrura nga autoriteti i tillë publik", pra nga MASHT, që është pala kontraktuese. Për kontratën e mëparshme për të njëjtat shërbime, 22-2442, referenca është lëshuar në emër të MASHT-it (P-6). Kjo tregon se Joni Travel e dinte se referenca duhej të vinte nga MASHT.
- **Përmbajtja bie ndesh me kontratën.** Vërtetimi thotë 36 muaj; kontrata thotë 12 muaj (17.09.2025 – 16.09.2026); edhe lista e vetë Joni Travel e jep përfundimin më 16.09.2026 (P-10). Nëse afati është 36 muaj, kontrata është "në realizim e sipër" dhe përjashtohet nga Kërkesa 9. Nëse afati është 12 muaj, vërtetimi përmban të dhëna të pasakta. Në të dy rastet kontrata nuk është "e dokumentuar plotësisht".
- **Vërteton më shumë sesa mund të dijë lëshuesi.** Kontrata mbulon dy institucione: Qendrën Burimore "Nëna Terezë" Mitrovicë J dhe shkollën speciale "B. Kosovës" Mitrovicë V (neni 1.1 i kontratës). Vërtetimi e përshkruan vetëm transportin për Shkollën Speciale "Kosovski Bozuri", por vërteton vlerën 63.751.00 €. Një institucion përfitues nuk mund të vërtetojë vlerën e realizuar të një kontrate kornize që e menaxhon MASHT.
- **Nuk ka raport përfundimtar të menaxherit të kontratës** sipas neneve 72A.4 dhe 73A.1 (c) të RrPP.

Prandaj vërtetimi nuk plotëson kushtet 1 dhe 3 dhe nuk mund të llogaritet.

PROVA P-5 – MASHT 25-6586-2-2-1: vërtetimi nuk është lëshuar nga autoriteti kontraktues (63,751 €)

Çka tregon: Kontratën e ka lidhur MASHT dhe e ka nënshkruar Xhemajl Buzuku për MASHT. Kontrata vlen 17.09.2025 – 16.09.2026 (neni 1.4). Vërtetimi i datës 15.10.2026 mban në krye Qendrën Burimore "Nëna Terezë", është nënshkruar nga Marta Popović, "Direktor Centra", dhe vulosur nga Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim "Kosovski Bozhur" – asnjëra palë në kontratë. Ai thotë se afati kohor i performancës ka qenë 36 muaj, ndërsa kontrata vlen 12 muaj, dhe vërteton vlerën e realizuar 63,751.00 €.

Dispozita: Evidenca 9 b) e FDT ("nga autoriteti përkatës"); neni 69.4.2 (i) i LPP; neni 25.16 (i) i RrPP.



Qendrën Burimore "Nëna Terezë" në Mitrovicë

VËRTETIM PËR REALIZIMIN E KONTRATËS

Me këtë vërtetojmë se kompania "JONI TRAVEL" SH.P.K., me seli në Skenderaj, me numër të biznesit 811014779, e përfaqësuar nga z. Avni Ademi, në cilësinë e kontraktuesit, ka realizuar projektin "Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta nga shtëpia në Shkolla Speciale "Kosovski Bozuri" në Mitrovicë dhe anasjelltas.",

Nr. i prokurimit: 208 Udheheqesi -256586-2-2-1

Nr. i brendshem: 208 025 018 221

Kontrata është nënshkruar më datë 18.09.2025, ndërsa afati kohor i performancës ka qenë 36 muaj. Kontrata është implementuar sipas kushteve të veçanta dhe të përgjithshme të saj. Vlera e shërbimeve të realizuara në kuadër të kësaj kontrate ka arritur shumën prej 63.751.00 €.

Data: 15.10.2026

Emri dhe mbiemri: MARTA POPOVIĆ

Pozita: DIREKTOR QENDRA

Nënshkrimi dhe vula:

Vërtetimi i datës 15.10.2026 i dorëzuar nga Joni Travel.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

PJESA I E KONTRATËS: **KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

Autoriteti kontraktues: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Operatori Ekonomik: JONI TRAVEL SH.P.K., Azem Bejta, -41000, SKENDERAJ (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër "Ofruesi i Shërbimeve", janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për

Shërbimet në vijim: Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta në Qendrën Burimore "Nëna Terezë" Mitrovicë J dhe shkolla speciale "B. Kosovës" Mitrovicë V.

Nr. i prokurimit: 208 Udheheqesi-25-6586-2-2-1
Nr. i brendshëm: 208 025 018 221

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim: Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta në Qendrën Burimore "Nëna Terezë" Mitrovicë J dhe shkolla speciale "B. Kosovës" Mitrovicë V.

[Autoriteti kontraktues kryen shërbime vetëm në emër të vet]

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohën me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me 17.09.2025 dhe përfundon në datën 16.09.2026

Neni 2 **Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 2 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në regjionin e Mitrovicës jugore dhe Mitrovicës veriore.

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.]

Neni 3 **Çmimi**

Kontrata 25-6586-2-2-1, faqja 1: autoriteti kontraktues dhe neni 1.4.

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është: 63,751.00 € (Gjashtëdhjetë e tremijë shtatëqind e pesëdhjetë e një euro).

Devijimi i lejuar nga vlera totale indikativë është [+ /- 30%].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kontrata Publike Kornizë;
(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
(d) Tenderi i Ofruesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
(e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
(f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë "do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet shqipe, në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues		**Për Ofruesin e Shërbimeve**	
Emri:	Xhemaj Buzuku	**Emri:**	Avni Ademi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	**Pozita:**	Drejtor
Nënshkrimi:		**Nënshkrimi:**	
Data:	18.09.2025	**Data:**	17/09/2025

JONI TRAVEL SH.P.K. SHENDËRI

Numri i Prokurimit: 208 Udheheqesi-25-6586-2-2-1, Nr. i brendshëm: 208 025 018 221, Titulli: Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta në Qendrën Burimore "Nëna Terezë" Mitrovicë J dhe shkolla speciale "B. Kosovës" Mitrovicë V.

Kontrata 25-6586-2-2-1, faqja 2: nënshkrimi për MASHT.

PROVA P-6 – MASHT 22-2442-2-2-1: referenca në emër të MASHT-it, pa datë përfundimi

Çka tregon: Për kontratën e mëparshme për të njëjtat shërbime, referenca është lëshuar në emër të MASHT-it. Ajo thotë se kontrata është "e përmbushur para afatit të përfundimit të kontratës", pa e dhënë datën e përfundimit, dhe e ka nënshkruar "Udhëheqës i divizionit të prokurimit".

Dispozita: Evidenca 9 b) e FDT; neni 69.4.2 (i) i LPP; neni 75.3 i RrPP.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Referencë

Datë: 24.04.2025

Prishtinë

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, lëshon këtë referencë për Operatorin Ekonomik: "JONI TRAVEL" SH.P.K., Azem Bejta, -41000, SKENDERAJ, lidhur me tenderin: Shërbime të transportit për QB "Nëna Terezë" Mitrovicë dhe Sh.s Buzhuri i Kosovës, me Nr. të prokurimit: 208 Udheheqesi-22-2442-2-2-1, Nr. i brendshëm: 208 022 010 221, e nënshkruar me datë 01.06.2022, e përmbushur para afatit të përfundimit të kontratës.

Vlera e kontratës së realizuar është 93,199.68 €.

Ne si Autoritet Kontraktues, jemi shumë të kënaqur me profesionalizimin e treguar nga operatori ekonomik i lartcekur, lidhur me realizimin e kontratës në fjalë. Shërbime të transportit për QB "Nëna Terezë" Mitrovicë dhe Sh.s Buzhuri i Kosovës, janë realizuara në kohë dhe kanë qenë shumë cilësore, në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në kontratë.

Xhemajl Buzuku
Udhëheqës i divizionit të prokurimit

Referenca e MASHT-it e datës 24.04.2025.

3. Referencat e MKK-së nuk vlejnë – 27,372.00 € (P-3, P-4)

Faktet. Kontratat MKK-211/23/020/221 dhe MKK-211/24/018/221 janë lidhur me DITA TRAVEL SH.P.K. Të dyja referencat janë të datës 11.12.2025, i drejtohen Operatorit Ekonomik Dita Travel, por shkruajnë: “Ne baze te raportit nga autoriteti kontraktues e konfirmojme se Operatori Ekonomik **Aktiv Shpk** ne cilesin e kontraktuesit(Furnizuesit) ka realizuar me sukses projektin”. Të dyja i ka nënshkruar z. Shaban Tafa, “Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik – MKK”.

Pse nuk vlejnë:

- **Vërtetojnë punën e një operatori tjetër.** Aktiv Shpk nuk është anëtar i grupit. Sipas nenit 71.4 të LPP, merret parasysh vetëm përvoja e anëtarëve të grupit. Një referencë që thotë se punën e ka kryer një operator tjetër nuk dëshmon përvojën e Dita Travel (neni 69.4.2 (i) LPP). AK nuk mund ta ndryshojë emrin në referencë, as ta pranojë një referencë të re pas afatit (neni 59.2 LPP; pikat 28.1 dhe 29.1 IUT).
- **Referenca për 24/018 është lëshuar para përfundimit.** Sipas pikës 6.4 të kushteve të veçanta, “Data e Përfundimit është 20.12.2025”. Referenca, e datës 11.12.2025, vërteton se kontrata është nënshkruar “me daten : 20.12.2024 deri me 19.12.2025 dhe eshte realizuar me sukses”. Në ditën e lëshimit, kontrata ishte në realizim e sipër dhe referenca vërteton ditë që nuk kishin ndodhur ende. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kërkesën 9 dhe me nenin 73A.1 (c) të RrPP.

Përveç kësaj, të dyja referencat i ka nënshkruar Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit Publik, të cilit neni 75.3, pika 1, i RrPP ia ndalon të nënshkruajë përfundimin e projektit (shih pikën 4). Prandaj të dyja referencat nuk plotësojnë kushtet 2 dhe 3.

PROVA P-3 – MKK-211/23/020/221: kontrata me Dita Travel, referenca për “Aktiv Shpk” (13,452 €)

Çka tregon: Kontrata është lidhur me Dita Travel SH.P.K. (NUI 811944132). Referenca e MKK-së konfirmon se projektin e ka realizuar “Operatori Ekonomik Aktiv Shpk”. E ka nënshkruar z. Shaban Tafa, “Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik – MKK”.

Dispozita: Evidenca 9 b) e FDT; neni 69.4.2 (i) dhe 71.4 i LPP; nenet 25.16 dhe 75.3 (1) e (3) të RrPP.



KONTRATË

Numri i kontratës[1]: 211-23-11931-2-2-1/C113

MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Dita Travel SH.P.K., BATLLAVË, BATLLAVË, 811944132, (ne vazhdim “Ofruesi i Shërbimeve”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

“Transporti i punëtorëve të MKK-së” me numër identifikues: 211-23-11931-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

“Transporti i punëtorëve të MKK-së”

No.	Lot

Kontrata MKK-211/23/020/221, faqja e palëve.

Republika e Kosovës

Република Косово / Republic of Kosovo

Qeveria / Влада/ Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Minstry of Communities and Return

REFERENCË:	**11.12.2025**
PËR:	Operatorin Ekonomik Dita Travel
CC:	
NGA:	**z.Shaban Tafa,** Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik – MKK
TEMA:	Reference për kontratën **"Transporti i punëtorëve të MKK-së"** me numer te prokurimit : **MKK-211/23/020/221**

Duke u bazuar në kërkesën e bere nga kompania **Dita Travel** leshohet kjo :

REFERENCË

Ne baze te raportit nga autoriteti kontraktues e konfirmojme se Operatori Ekonomik Aktiv Shpk ne cilesin e kontraktuesit(Furnizuesit) ka realizuar me sukses projektin me emrin **"Transporti i punëtorëve të MKK-së"** me numer te prokurimit : **MKK-211/23/020/221**i cili eshte nenshkruar me daten : 21.12.2023 deri me 20.12.2024 dhe eshte realizuar me sukses ne shumen prej : 13,452.00 €

Bashkepunimi me kete OE ishte shume i suksesshem, prandaj shprehim

Referenca e MKK-së e datës 11.12.2025 për kontratën MKK-211/23/020/221.

PROVA P-4 – MKK-211/24/018/221: referenca për “Aktiv Shpk”, lëshuar para përfundimit (13,920 €)

Çka tregon: Kontrata është lidhur me Dita Travel. Referenca, e datës 11.12.2025, konfirmon realizimin nga “Aktiv Shpk” për periudhën 20.12.2024 – 19.12.2025, pra edhe për ditë pas lëshimit. Sipas kontratës, data e përfundimit është 20.12.2025. E ka nënshkruar Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit Publik.

Dispozita: Kërkesa 9 (“jo në realizim e sipër”) dhe Evidenca 9 b); nenet 70.9, 72A.4, 73A.1 (c) dhe 75.3 të RrPP.



KONTRATË

Numri i kontratës[1]: 211-24-11427-2-2-1/C136

MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Dita Travel SH.P.K., BATLLAVË, BATLLAVË, 811944132. (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

"Shërbime të transportit për nevojat e MKK-së" me numër identifikues: **211-24-11427-2-2-1**

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

"Shërbime të transportit për nevojat e MKK-së"

No.	Lot
1	**"Shërbime të transportit për nevojat e MKK-së"**

Kontrata MKK-211/24/018/221, faqja e palëve.

Republika e Kosovës

Република Косово / Republic of Kosovo

Qeveria / Влада/ Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак / Minstry of Communities and Return

REFERENCË:	**11.12.2025**
PËR:	Operatorin Ekonomik Dita Travel
CC:	
NGA:	**z.Shaban Tafa,** Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit Publik – MKK
TEMA:	Reference për kontraten "**Transporti i punetoreve te MKK-se**" me numer te prokurimit : **MKK-211/24/018/221**

Duke u bazuar në kërkesën e bere nga kompania **Dita Travel** leshohet kjo :

REFERENCË

Ne baze te raportit nga autoriteti kontraktues e konfirmojme se Operatori Ekonomik Aktiv Shpk ne cilesin e kontraktuesit(Furnizuesit) ka realizuar me sukses projektin me emrin "**Transporti i punetoreve te MKK-se**" me numer te prokurimit : **MKK-211/24/018/221**i cili eshte nenshkruar me daten : 20.12.2024 deri me 19.12.2025 dhe eshte realizuar me sukses ne shumen prej : 13,920.00 €

Bashkepunimi me kete OE ishte shume i suksesshem ...

Referenca e MKK-së e datës 11.12.2025 për kontratën MKK-211/24/018/221.



KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 211-24-11427-2-2-1/C136

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		*Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK*
Përshkrimi i nenit	*Nr. Nenit*	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Fillimi dhe përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 21.12.2024.
	6.4	Data e Përfundimit është 20.12.2025.
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është Vendi i kryerjes së shërbimeve është Linja e transportit Relacioni Prishtinë - Fushë Kosovë (në ora 07 20 duke filluar nga mbrapa Komunës së Prishtinës - mbrapa Teatrit - mbrapa Restaurant Rugova - te Xhambazt- furra Qerimi 1 - rrethi i Spitalit - Posta e madhe - bulevardi Bill Clinton - stacioni i Hekurudhes Fushë Kosovë dhe anasjelltas në ora 16 05).
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është *Qenan Vuqiterna* email : qenan.vuqiterna@rks-gov.net
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është *0.25%* në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: **1,392.00 EUR.**
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: a) Automjeti motorik i Palës së Tretë *[shëno shumën]* b) Përgjegjësia e Palës së Tretë *[shëno shumën]* c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve *[shëno shumën]* d) Përgjegjësia profesionale *[shëno shumën]* e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës *[shëno shumën]*
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesat do te behen cdo muaj, pas pranimit te faturës nga ana e menaxherit te projektit dhe pas përfundimit te raportit se shërbimet kane qene ne rregull dhe konfom kontratës.

1

Kushtet e veçanta të kontratës: “6.4 Data e Përfundimit është 20.12.2025”.

4. Referencat e Policisë së Kosovës nuk vlejnë – 238,884.04 € (P-7, P-8, P-9, P-10)

Faktet.

Kontrata	Nënshkruar	Neni 1.4 – përfundon	Referenca	Vlera në referencë
214-23-10338-225	06.10.2023	05.10.2026 (36 muaj)	28.04.2025	119,837.44 €

Kontrata	Nënshkruar	Neni 1.4 – përfundon	Referenca	Vlera në referencë
214-24-5575-225	26.06.2024	25.06.2027 (36 muaj)	28.04.2025	119,046.60 €

Të dyja janë kontrata kornize. Të dyja referencat thonë se afati i kontratës është 36 muaj, “mirëpo eshte bere implementimi”, dhe se vlera e shërbimeve “ka arritur shumën” e shënuar. I ka nënshkruar Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit, jo menaxheri i kontratës.

Pse nuk vlejnë:

- **Kontratat ishin në realizim e sipër.** Më 24.09.2026, dita e fundit e periudhës, të dyja kontratat ishin në fuqi; kontrata 5575 është në fuqi edhe sot, deri më 25.06.2027. Kërkesa 9 i përjashton shprehimisht kontratat “në realizim e sipër”.
- **Referencat janë lëshuar në mes të kontratës.** Më 28.04.2025, kontrata 10338 kishte edhe 17 muaj, kurse kontrata 5575 edhe 26 muaj. Ato nuk thonë se kontrata ka përfunduar. Shuma që “ka arritur” deri atëherë nuk është vlera e kontratës së përfunduar.
- **Referencat i ka nënshkruar zyrtari që e ka të ndaluar të vërtetojë përfundimin.** Sipas nenit 75.3, pika 1, të RrPP, zyrtari përgjegjës i prokurimit nënshkruan kontratën, por e ka të ndaluar të nënshkruajë përfundimin e projektit, pranimin e shërbimeve ose pagesën. Sipas pikës 3 të të njëjtit nen, përfundimin e projektit e nënshkruan njësia pranuese ose menaxheri i projektit. Sipas nenit 70.9 të RrPP, pas emërimit të menaxherit, menaxhimi i kontratës kalon nga departamenti i prokurimit te menaxheri i kontratës. Sipas neneve 72A.4 dhe 73A.1 (c), obligimet konsiderohen të përfunduara vetëm me raportin përfundimtar të menaxherit. Referencat e Policisë janë lëshuar nga “Drejtoria e Prokurimit” dhe i ka nënshkruar “Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit” (P-7, P-8). Ky zyrtar nuk ka kompetencë ta vërtetojë përfundimin e kontratës dhe referencat nuk mbështeten në asnjë raport të menaxherit të kontratës. Prandaj ato nuk dëshmojnë se kontrata është përfunduar. Për krahasim, referencën e Komunës së Skenderajt për kontratën 643-24-10421 e ka lëshuar “Menagjeri i Kontratës” (P-11).
- **Vetë AK e zbaton këtë rregull.** Me emailin e 25.08.2026, Ministria e Mbrojtjes i ka refuzuar ankuesit një referencë sepse kontrata ishte “ende në proces të realizimit”. Ajo shkroi se referencat lëshohen “vetëm pas përfundimit të plotë të kontratës dhe konfirmimit nga menaxheri i kontratës” (P-9).
- **Lista e Joni Travel përmban të dhëna të pasakta.** Ajo i paraqet këto kontrata si të përfunduara 100%: 10338 më 31.12.2023 me 120,000.00, dhe 5575 më 31.12.2024 me 124,000.01 (P-10). Këto data dhe vlera bien ndesh me nenin 1.4 të kontratave dhe me referencat e Policisë. Versioni i listës me titull “perfundimtare” nuk është i nënshkruar dhe i vulosur, siç e kërkon Evidenca 9 a). Për të dhëna të tilla zbatohet neni 26.14 i RrPP.

Prandaj të dyja referencat nuk plotësojnë kushtin 3 dhe nuk mund të llogariten.

PROVA P-7 – Policia e Kosovës 214-23-10338: referencë gjatë realizimit (119,837.44 €)

Çka tregon: Kontrata kornizë 36-mujore vlen deri më 05.10.2026 (neni 1.4), pra pas publikimit të njoftimit për kontratë (24.09.2026). Referenca e datës 28.04.2025 thotë se afati i performancës ka qenë 36 muaj dhe se vlera "ka arritur shumën". Nuk thotë se kontrata ka përfunduar dhe nuk ka raport përfundimtar të menaxherit të kontratës.

Dispozita: Kërkesa 9 ("jo në realizim e sipër") dhe Evidenca 9; nenet 25.13, 72A.4 dhe 73A.1 (c) të RrPP; neni 59.4 i LPP. Referenca është nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit, të cilit neni 75.3 (1) i RrPP ia ndalon të nënshkruajë përfundimin e projektit; sipas nenit 75.3 (3) dhe 70.9 këtë e bën menaxheri.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme MinistarstvoUnutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Me kërkese të "JONI TRAVEL" SH.P.K , Drejtoria e Prokurimit –Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse në Policinë e Kosovës lëshon këtë:

REFERENCË

Me këtë konfirmojmë se kompania **"JONI TRAVEL SH.P.K** me seli në Skenderaj Pejë me nr. të Biznesit 811014779 me përfaqësuesen **z. Avni Ademi,** në cilësinë e Kontraktuesit për projektin **"SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTAREVE PËR NEVOJAT E PK-SË RITENDER ",** me numër te prokurimit **214-23-10338-225 & 214-23-131-225**.

Kontrata është nënshkruar me date **06.10.2023** dhe afati kohor i përformancës ka qene 36 Muaj mirëpo eshte bere implementimi i kontratës sipas kushteve te veçanta dhe të përgjithshme te kontratës vlera e Shërbimeve për këtë kontrate ka arritur shumën **119,837.44** €.

Me respekt !
Artan Fejza
Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit
Policia e Kosovës,
Tel: 038 504 504 17 20
artan.fejza@kosovopolice.com

Prishtinë,
Datë: 28.04.2025

Referenca e Policisë së Kosovës e datës 28.04.2025.

PJESA I E KONTRATËS: **KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

POLICIA E KOSOVËS, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99, ndërtesa e re Administratës, kati II, zyra 31, Prishtinë,

Dhe

JONI TRAVEL SH.P.K. Email adresa: jonitravelshpk@gmail.com, tel 049/888-839; 045/888-873, me nr. biznesit: 811014779.

janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për shërbimet në vijim:

SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK – së RI-TENDER EKSTREM EMERGJENTE

me numër identifikues 214-23-10338-225 & 214-23-131-225

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK –së RI-TENDER

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performophen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës nga të dy palet dhe përmbyllet për një periudhë prej 36

Kontrata 214-23-10338: neni 1.4, afati deri më 05.10.2026.

PROVA P-8 – Policia e Kosovës 214-24-5575: referencë gjatë realizimit (119,046.60 €)

Çka tregon: Kontrata kornizë 36-mujore vlen deri më 25.06.2027 (neni 1.4). Referenca e datës 28.04.2025 ka të njëjtin formulim, është nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit dhe nuk konfirmon përfundimin e kontratës.

Dispozita: Kërkesa 9 dhe Evidenca 9; nenet 70.9, 72A.4, 73A.1 (c) dhe 75.3 (1) e (3) të RrPP; neni 59.4 i LPP.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme MinistarstvoUnutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Me kërkese të "JONI TRAVEL" SH.P.K , Drejtoria e Prokurimit –Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse në Policinë e Kosovës lëshon këtë:

REFERENCË

Me këtë konfirmojmë se kompania **"JONI TRAVEL SH.P.K** me seli në Skenderaj Pejë me nr. të Biznesit 811014779 me përfaqësuesen **z. Avni Ademi**, në cilësinë e Kontraktuesit për projektin **"SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTAREVE PËR NEVOJAT E PK-SË ",** me numër te prokurimit **214-24-5575-225 & 214-24-083-225**.

Kontrata është nënshkruar me date **26.06.2024** dhe afati kohor i përformancës ka qene 36 Muaj mirëpo eshte bere implementimi i kontratës sipas kushteve te veçanta dhe të përgjithshme te kontratës vlera e Shërbimeve për këtë kontrate ka arritur shumën 119,046.60 €.

Me respekt !
Artan Fejza
Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit
Policia e Kosovës,
Tel: 038 504 504 17 20
artan.fejza@kosovopolice.com

Prishtinë,
Datë: 28.04.2025

Referenca e Policisë së Kosovës e datës 28.04.2025.

PJESA I E KONTRATËS: **KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

POLICIA E KOSOVËS, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99, ndërtesa e re Administratës, kati II, zyra 31, Prishtinë, Dhe
JONI TRAVEL SH.P.K. Email adresa: jonitravelshpk@gmail.com, tel 049-888-839 & 045-888-873, me nr. biznesit: 811014779.

janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për shërbimet në vijim:

SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK – së EKSTREM EMERGJENTE

me numër identifikues 214-24-5575-225 & 214-24-083-225

Neni 1 **Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK –së

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performophen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontratës nga të dy palet dhe përmbyllet për një periudhë prej 36 muaj deri me datën 25/06/2027.

Neni 2 **Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve: Operatori Ekonomik fitues është i obligуar që ti përgjigjet thirrjeve të AK në afat prej maksimum 2 orë dhe të dërgojë Automjeteve transportuese sipas kërkesës së AK në lokacionin e kërkuar dhe Automjetove transportuese me numrin e ulëseve të kërkuara

Kontrata 214-24-5575: neni 1.4, afati deri më 25.06.2027.

PROVA P-9 – Emaili i Ministrisë së Mbrojtjes (AK), 25.08.2026: referencat vetëm pas përfundimit të plotë

Çka tregon: I njëjti autoritet kontraktues i ka shkruar ankuesit se referencat "mund të lëshohen vetëm pas përfundimit të plotë të kontratës dhe konfirmimit nga menaxheri i kontratës" dhe e ka refuzuar referencën sepse kontrata ishte "ende në proces të realizimit". Në vlerësimin e grupit, AK ka pranuar referenca të lëshuara gjatë realizimit të kontratave.

Dispozita: Neni 7 i LPP (trajtimi i barabartë); neni 73A.1 (c) i RrPP; Kërkesa 9 e FDT.



11:25 5G

Found in Hotmail Inbox

AT Arsim Tahiri 25.8.26

RE: Njoftim lidhur me kërkesën për lëshimin e referencës

Të nderuar,

Lidhur me kërkesën tuaj për lëshimin e referencës për kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe operatorit ekonomik "Arditi Tours" SHPK, për ofrimin e shërbimeve të transportit për bartjen e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, ju njoftojmë se referenca e kërkuar nuk mund të lëshohet në këtë fazë.

Referencat për realizimin e kontratave mund të lëshohen vetëm pas përfundimit të plotë të kontratës dhe konfirmimit nga menaxheri i kontratës se të gjitha obligimet kontraktuale janë përmbushur në pajtim me kushtet e përcaktuara.

Meqenëse kontrata në fjalë është ende në proces të realizimit, Autoriteti Kontraktues nuk mund të konfirmojë përfundimin e suksesshëm të saj dhe, rrjedhimisht, nuk mund ta lëshojë referencën e kërkuar për periudhën 2024–2025.

Pas përfundimit të kontratës dhe përmbylljes së të gjitha obligimeve kontraktuale, mund ta parashtroni përsëri kërkesën tuaj, e cila do të shqyrtohet në bazë të raportit dhe konfirmimit përfundimtar të menaxherit të kontratës.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

Email nga Ministria e Mbrojtjes, i datës 25.08.2026.

PROVA P-10 – Lista e kontratave e Joni Travel: dy versione që nuk përputhen me referencat

Çka tregon: Lista i paraqet kontratat e Policisë 214-23-10338, 214-24-5575 dhe 214-24-10286 si të përfunduara 100% më 31.12.2023 dhe 31.12.2024, ndërsa kontratat janë 36-mujore dhe referencat e Policisë (28.04.2025) japin vlera më të ulëta. Versioni “perfundimtare” nuk është i nënshkruar dhe i vulosur. Versioni tjetër e shënon përfundimin e kontratës së MASHT-it 2025 me datën “18.7.1905”.

Dispozita: Evidenca 9 a) e FDT (“të nënshkruar dhe vulosur nga OE”); nenet 26.14 dhe 26.16 të RrPP; pika 10 e Informatave shtesë të FDT.

JONI TRAVEL SH.P.K SH.P.K LISTA E PROJEKTEVE - KONTRATAVE ME REFERENCA

Nr.	EMRI I KONTRATËS-PËRSHKRIMI I PUNËVE	NR PROKURIMIT	VLERA E KONTRATËS	DATA E NËNSHKRIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	% E REALIZIMIT	VLERA E PUNEVE TE PËRFUNDUARA	PUNËDHËNËSI	KONTAKTI I PUNËDHËNËSIT
1	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK	KEK18-099-211	653 021,33 €	14.12.2018	30.12.2021	100%	653 021,33 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
2	SHERBIMET E TRANSPORTIT PËR NXËNSIT ME NEVOJ	643-17-037221	25 500,00 €	16.05.2018	25.05.2018	100%	25 500,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
3	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK DRENAS SKENDERAJ	KEK22-4012-2-9	37 000,00 €	23.02.2022	28.02.2022	100%	37 000,00 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
4	Sherbime të transportit për QB Nina Terzat Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Budhari i Kosovës në Mitrovicën e veriut	2021/208 Udhetoqesi-20-3492-2-2-1/	108 371,20 €	26.01.2022	26.01.2023	100%	108 371,20 €	MASHT	ZYRA E PROKURIMIT
5	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK DRENAS SKENDERAJ	KEK22-2410229	56 516,00 €	17.03.2022	30.05.2022	100%	56 516,00 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
6	TRANSPORTI I NXENSVE ME NEVOJA TE VEQANTA	643-20-9628221	73 260,00 €	18.06.2020	30.06.2020	100%	73 260,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
7	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR [illegible]	214-23-10338-225	120.000.00	06.10.2023	31.12.2023	100%	120.000.00	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
8	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK -së	[illegible]	124.000.00	07.11.2024	31.12.2024	100%	124.000.00	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
9	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK -së	[illegible]	124.000.01	26.06.2024	31.12.2024	100%	124.000.01	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
10	Sherbime të transportit për QB Nina Terzat Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Budhari i Kosovës në Mitrovicën e veriut	22-2442-2-21	93 199,68 €	01.06.2022	01.06.2024	100%	93 199,68 €	MASHT	ZYRA E PROKURIMIT
11	K.K. SKENDERAJ	643-24-10421-2-2-1	92,925,00	22.11.2024			87,340,00	K.K. SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
12	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni	255586-2-2-1	63,751.00 €	17.9.2025	16.9.2026	100%	63,751.00 €	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni	ZYRA E PROKURIMIT
13	TRANSPORTI I NXENSVE ME NEVOJA TE VEQANTA	643-22-9103-221	88 280,00 €	17.11.2022	01.10.2024	100%	88 280,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
	VLERA E KONTRATAVE TE PERFUNDUARA								

Lista “Lista_e_kontratave_joni_perfundimtare”, faqja 1.

TOTALI		1 135 148,21 €		

JONI TRAVEL SH.P.K SH.P.K

E njëjta listë, faqja 2: totali 1,135,148.21 €, pa nënshkrim dhe vulë.



JONI TRAVEL SH.P.K - SH.P.K LISTA E PROJEKTEVE - KONTRATAVE ME REFERENCA

Nr.	EMRI I KONTRATËS-PËRSHKRIMI I PUNËVE	NR PROKURIMIT	VLERA E KONTRATËS	DATA E NËNSHKRIMIT	DATA E PËRFUNDIMIT	% E REALIZIMIT	VLERA E PUNEVE TE PËRFUNDUARA	PUNËDHËNËSI	KONTAKTI I PUNËDHËNËSIT
1	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK	KEK18-099-211	653 021,33 €	14.12.2018	30.12.2021	100%	653 021,33 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
2	SHERBIMET E TRANSPORTIT PËR NXËNSIT ME NEVOJ	643-17-037221	25 500,00 €	16.05.2018	25.05.2018	100%	25 500,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
3	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK DRENAS SKENDERAJ	KEK22-6812-2-5	37 000,00 €	23.02.2022	28.02.2022	100%	37 000,00 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
4	Shërbime të transportit për QB Nina Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Bushati i Kosovës në Mitrovicën e veriut	2021/208 Udhëhoqesi-20-3492-2-2-1/	108 371,20 €	26.01.2022	26.01.2023	100%	108 371,20 €	MASHT	ZYRA E PROKURIMIT
5	SHERBIMET E TRANSPORTIT TË PUNËTORVE TË KEK DRENAS SKENDERAJ	KEK22-2410225	56 516,00 €	17.03.2022	30.05.2022	100%	56 516,00 €	KEK	ZYRA E PROKURIMIT
6	TRANSPORTI I NXENSVE ME NEVOJA TE VEQANTA	643-20-5428221	73 260,00 €	18.06.2020	30.06.2020	100%	73 260,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
7	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK -si	214-23-10138-225	128.000.00	06.10.2023	31.12.2023	100%	128.000.00	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
8	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK -si	[illegible]	124.000.00	07.11.2024	31.12.2024	100%	124.000.00	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
9	SHËRBIMET E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE PËR NEVOJAT E PK -si	[illegible]	124.000.01	26.06.2024	31.12.2024	100%	124.000.01	POLICIA E KOSOVES	ZYRA E PROKURIMIT
10	Shërbime të transportit për QB Nina Terezë Mitrovicë jugore dhe shkolla speciale Bushati i Kosovës në Mitrovicën e veriut	22-2442-2-21	93 199,68 €	01.06.2022	01.06.2024	100%	93 199,68 €	MASHT	ZYRA E PROKURIMIT
11	K.K. SKENDERAJ	643-24-10421-2-2-1	92,925,00	22.11.2024	2026	100%	87,340,00	K.K. SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
12	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni	255586-2-2-1	63,751.00 €	17.9.2025	18.7.1905	100%	63,751.00 €	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni	ZYRA E PROKURIMIT
13	TRANSPORTI I NXENSVE ME NEVOJA TE VEQANTA	643-22-9103-221	88 280,00 €	17.11.2022	01.10.2024	100%	88 280,00 €	K.K.SKENDERAJ	ZYRA E PROKURIMIT
	VLERA E KONTRATAVE TE PERFUNDUARA								

Lista “Lista e kontratave--JONI TRAVEL”, faqja 1.



TOTALI		1 135 148,21 €	

JONI TRAVEL SH.P.K SH.P.K

E njëjta listë, faqja 2.

5. Referencat e Don Bosko nuk vlejnë – 129,611.00 € (P-12)

Faktet. Dita Travel ka dorëzuar tri referenca nga “Qendra Sociale Edukative Don Bosko” (blerës privat): Referenca 1, periudha 15.04.2023 – 31.12.2023, 37,730.00 €; Referenca 2, viti 2024, 32,613.00 €; Referenca 3, periudha 01.01.2025 – 31.01.2025, 59,268.00 €. Referencat përshkruajnë “shërbime turistike dhe transporti”.

Pse nuk vlejnë:

- **Mungojnë të dhënat që i kërkon Evidenca 9 b).** Asnjë referencë nuk ka numër kontrate, vlerë kontrate dhe datë lëshimi. Marrëveshja e bashkëpunimit nuk ka vlerë: Don Bosko nuk

është e detyruar të blerë (neni 2) dhe çmimi caktohet veçmas për çdo rast (neni 5).

- **Referenca 1 përfshin periudhë jashtë tri viteve.** Ajo fillon më 15.04.2023, para 24.09.2023. Pagesa e 20.04.2023 prej 12,920 € është jashtë periudhës. Referenca nuk e ndan vlerën brenda dhe jashtë periudhës, prandaj nuk është “e dokumentuar plotësisht”.
- **Dëshmia bankare nuk përputhet me Referencën 3.** Referenca flet për janarin 2025. Pagesat e paraqitura janë nga marsi deri në qershor 2025, përfshirë udhëtimin e 19.03.2025 dhe pagesën e 13.06.2025 prej 31,150 € për Sarandë dhe Ksamil. Neni 25.16 (ii) i RrPP kërkon dëshmi bankare për vlerën e vërtetuar, jo pagesa për periudha të tjera.
- **Vlera e transportit nuk është dëshmuar.** Marrëveshja ka për objekt “organizimin e akomodimit dhe transportin e nxënësve”, pagesat kanë përshkrimin “Transport, akomodim” dhe vetë lista e Dita Travel i përshkruan si “SHËRBIME TRANSPORTI DHE AKOMODIMI BRENDA DHE JASHTË VENDIT”. Asnjë dokument nuk e ndan vlerën e transportit nga ajo e akomodimit.
- **Pagesat nuk janë dëshmi bankare zyrtare.** Ato janë printime e-banking me shënimin “COPY”, me pagues “Shoqata Social Edukative Don Bosko”, ndërsa lëshuesi i referencave është “Qendra Sociale Edukative Don Bosko”.

Prandaj referencat e Don Bosko nuk plotësojnë kushtin 4 dhe Referenca 1 as kushtin 3.

PROVA P-12 – Don Bosko: referenca pa numër dhe vlerë kontrate, shërbime turistike me akomodim (129,611 €)

Çka tregon: Referencat nuk kanë datë lëshimi, numër kontrate dhe vlerë kontrate. Referenca 1 mbulon 15.04.2023 – 31.12.2023, pjesërisht para 24.09.2023. Marrëveshja e bashkëpunimit ka për objekt “shërbime turistike”, “organizimin e akomodimit dhe transportin e nxënësve”; Don Bosko nuk është e obliguar të blejë (neni 2) dhe çmimi caktohet “veçmas” për çdo rast (neni 5). Referenca e vitit 2025 jep periudhën 01.01.2025 – 31.01.2025, kurse pagesat janë nga marsi deri në qershor 2025. Pagesat janë printime e-banking “COPY”, nga “Shoqata Social Edukative Don Bosko”, me përshkrimin “Transport, akomodim”. Edhe lista e referencave e Dita Travel i quan këto shërbime “transporti dhe akomodimi”.

Dispozita: Evidenca 9 b) e FDT (numri dhe vlera e kontratës; dëshmi bankare për referencat private); neni 69.4.2 (ii) i LPP; Kërkesa 9 (“natyrë e njëjtë ose e ngjashme”).

REFERENCË

QENDRA SOCIALE EDUKATIVE DON BOSKO

Selia: Prishtinë
Nr. i biznesit: 601200166

Lënda: Referencë për Kompaninë Turistike Dita Travel SH.P.K – Referenca 1

Me anë të kësaj reference, vërtetojmë se Kompania Turistike Dita Travel SH.P.K, me numër biznesi 811944132, ka bashkëpunuar me Qendrën Sociale Edukative Don Bosko duke ofruar shërbime turistike dhe transporti sipas kërkesave dhe nevojave tona.

Gjatë periudhës 15.04.2023 deri më 31.12.2023, Kompania Turistike Dita Travel SH.P.K ka kryer me përgjegjësi dhe korrektësi shërbime për Qendrën Sociale Edukative Don Bosko në vlerë totale prej 37,730.00 euro.

Jemi të kënaqur me shërbimet e ofruara nga kjo kompani, duke vlerësuar profesionalizmin, korrektësinë, përkushtimin dhe realizimin e shërbimeve në përputhje me kërkesat tona.

Po ashtu, vlera e lartcekur e shërbimeve dëshmohet edhe përmes transaksioneve bankare të realizuara ndërmjet palëve.

Kjo referencë lëshohet me kërkesë të palës së interesuar, për t'u përdorur për nevoja administrative dhe zyrtare.

Për Qendrën Sociale Edukative Don Bosko

Don Dominik Kukeli

Emri dhe mbiemri

Drejtor

Pozita

Nënshkrimi dhe vula

Referenca e Don Bosko për vitin 2023 (37,730 €).

REFERENCË

QENDRA SOCIALE EDUKATIVE DON BOSKO

Selia: Prishtinë
Nr. i biznesit: 601200166

Lënda: Referencë për Kompaninë Turistike Dita Travel SH.P.K – Referenca 3

Me anë të kësaj reference, vërtetojmë se Kompania Turistike Dita Travel SH.P.K, me numër biznesi 811944132, ka bashkëpunuar me Qendrën Sociale Edukative Don Bosko duke ofruar shërbime turistike dhe transporti sipas kërkesave dhe nevojave tona.

Gjatë periudhës 01.01.2025 deri më 31.01.2025, Kompania Turistike Dita Travel SH.P.K ka kryer me përgjegjësi dhe korrektesi shërbime per Qendrën Sociale Edukative Don Bosko në vlerë totale prej 59,268.00 euro.

Jemi të kënaqur me shërbimet e ofruara nga kjo kompani, duke vlerësuar profesionalizmin, korrektësinë, përkushtimin dhe realizimin e shërbimeve në përputhje me kërkesat tona.

Po ashtu, vlera e lartcekur e shërbimeve dëshmohet edhe përmes transaksioneve bankare të realizuara ndërmjet palëve.

Kjo referencë lëshohet me kërkesë të palës së interesuar, për t'u përdorur për nevoja administrative dhe zyrtare.

Për Qendrën Sociale Edukative Don Bosko

Don Dominik Kakeli

Emri dhe mbiemri

Pozita

Nënshkrimi dhe vula

DITA
KOMPANIA TURISTIKE

KONTRATË BASHKËPUNIMI

Kjo kontratë bashkëpunimi lidhet ndërmjet palëve si më poshtë:

Pala e parë	Kompania Turistike Dita Travel Sh.P.K, me numër biznesi 811944132, me seli në Podujevë (në vijim: "DITA TRAVEL").
Pala e dytë	Qendra Sociale Edukative Don Bosko, me numër biznesi 601200166, me seli në Prishtinë (në vijim: "DON BOSKO").

1. **Neni 1 – Objekti i kontratës**
   Me këtë kontratë, palët pajtohen që DITA TRAVEL do t'i ofrojë DON BOSKO-s shërbime turistike, përkatësisht organizimin e akomodimit dhe transportin e nxënësve, sa herë që shkolla paraqet kërkesë për këto shërbime.
2. **Neni 2 – Kohëzgjatja**
   Kjo marrëveshje vlen për periudhën nga 15.04.2023 deri më 31.12.2023 megjithatë kjo kontrat nuk nënkupton se DON BOSKO është e obligu ar që të gjitha sherbimet e nevojshme për transport ti përfundoj me kompanin dita por vetëm kur qse Don Bosko ta ftoj për pjesmarrje në ofertë .
3. **Neni 3 – Obligimet e DITA TRAVEL**
   DITA TRAVEL obligohet që të ofrojë shërbime profesionale, të sigurta dhe në kohë, në përputhje me kërkesat konkrete të DON BOSKO-s dhe me legjislacionin në fuqi.
4. **Neni 4 – Obligimet e DON BOSKO**
   DON BOSKO obligohet që të paraqesë me kohë kërkesat për transport dhe/ose akomodim, duke specifikuar datat, destinacionin, numrin e nxënësve dhe detajet e tjera të nevojshme për realizimin e shërbimit.
5. **Neni 5 – Çmimi dhe pagesa**
   Për secilin shërbim të kërkuar gjatë periudhës së kësaj kontrate, çmimi, mënyra e pagesës dhe kushtet specifike do të përcaktohen veçmas përmes ofertës, faturës ose marrëveshjes përkatëse për rastin konkret.
6. **Neni 6 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**
   Palët do të përpiqen që çdo mosmarrëveshje ta zgjidhin me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet marrëveshje, kompetente do të jetë gjykata përkatëse në Republikën e Kosovës.
7. **Neni 7 – Dispozitat përfundimtare**
   Kjo kontratë përpilohet në dy ekzemplarë me fuqi të njëjtë juridike, nga një për secilën palë, dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Për DITA TRAVEL Sh.P.K
DITA TRAVEL PODUJEVË
Nënshkrimi dhe vula

Për Qendra Sociale Edukative Don Bosko
Qendra Sociale Edukative "DON BOSKO" Prishtinë
Nënshkrimi dhe vula

Kontrata e bashkëpunimit: nenet 1, 2 dhe 5.

TEB

TEB KOSOVO

Shopping Centre Napredaku No.34, Pristine Pr?Sht?Ne 10000 PRISHTINA

Receipt

Date : 20/04/2023
No : 00000962

Account No:20-20-0002152158-18
Sender:1300001001046490
Beneficiary:DITA TRAVEL

SHOQATA SOCIAL EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINE Value : 20/04/23	SHOQATA SOCIAL	EUR	12,920.00+

DITA TRAVEL SHPK	SHOQATA SOCIAL EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINE PAGESE E FAT.NR.51-2023
	EUR.12,920.00 credited to your account.

- 811944132

For Supp.Info:

Regards,
DARDANIA BRANCH

Approved electronically.

*]COPY

Print

Pagesa e 20.04.2023, 12,920 € (para 24.09.2023), “COPY”, paguesi “Shoqata Social Edukative Don Bosko”.

TEB KOSOVO

Shopping Centre Napredaku No.34, Pristine Pr?Sht?Ne 10000 PRISHTINA

Receipt

Date : 25/03/2025
No : 00002330

Account No:20-20-0002152158-18
Sender:1300001001046490
Beneficiary:N.T.P DITA travel

SHOQATA SOCIAL EDUKATIVE DON BOSKO PRISH Fat. Nr. 19/2025, EUR 4,500.00+
Value : 25/03/25

DITA TRAVEL SHPK	Fat. Nr. 19/2025, Transport, akomadim per nxanesa, Tirane 3 dite, dt.19.03.2025
	EUR.4,500.00 credited to your account.

- 811944132

For Supp.Info:

Regards,
DARDANIA BRANCH

Approved electronically.

[*]COPY

Print

Pagesa e faturës 19/2025 për udhëtimin e 19.03.2025 (jashtë periudhës së referencës).

TEB KOSOVO

Shopping Centre Napredaku No.34, Pristine Pr?Sht?Ne 10000 PRISHTINA

Receipt

Date : 13/06/2025
No : 00003318

Account No:20-20-0002152158-18
Incoming Remittance:41924223
Sender:SHOQATA SOCIAL EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINE
Sender Bank:BANKA PER BIZNES/

SHOQATA SOCIAL EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINE-Paid from incom Value : 13/06/25	EUR 31,150.00+
DITA TRAVEL SEPK	Fat. Nr. 71-2025, Transport, akomadim per nxanesa, Prishtine, Sarande, Ksamil,Ra
	EUR.31,150.00 credited to your account.

- 811944132

For Supp.Info:

Regards,
DARDANIA BRANCH

Approved electronically.

[*]COPY

Print

Pagesa e 13.06.2025, 31,150 €: transport dhe akomodim, Sarandë, Ksamil.

Aneksi 7. LISTA E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE

LISTA E REFERENCAVE

TITULLI	SHERBIMET E PERFSHIRA	SHUMA	DATA	PRANUESI
Transporti i punëtorëve te MKK-se	SHERBIME TRANSPORTI	14,268.00	18.12.2023	MINISTRIA PER KOMUNITET DHE KTHIM
Transporti i punëtorëve te MKK-se	SHERBIME TRANSPORTI	13,452.00	20.12.2024	MINISTRIA PER KOMUNITET DHE KTHIM
sherbime te transportit per nevojat e MKK-se	SHERBIME TRANSPORTI	13,920.00	19.12.2025	MINISTRIA PER KOMUNITET DHE KTHIM
Transporti (bartja) e personave të riatdhesuar me numër identifikues 214-22-11730-2-2-1	SHERBIME TRANSPORTI	16,000.00	22.12.2025	MINISTRIA PER KOMUNITET DHE KTHIM
Sherbime turistike, perkatesisht organizimin e akomodimit dhe transportin e nxenesve	SHERBIME TRANSPORTI DHE AKOMODIMI BRENDA DHE JASHT VENDIT	37,730.00	31.12.2023	QENDRA SOCIALE EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINË
Sherbime turistike, perkatesisht organizimin e akomodimit dhe transportin e nxenesve	SHERBIME TRANSPORTI DHE AKOMODIMI BRENDA DHE JASHT VENDIT	32,613.00	31.12.2024	QENDRA SOCIALE EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINË
Sherbime turistike, perkatesisht organizimin e akomodimit dhe transportin e nxenesve	SHERBIME TRANSPORTI DHE AKOMODIMI BRENDA DHE JASHT VENDIT	59,268.00	31.01.2025	QENDRA SOCIALE EDUKATIVE DON BOSKO PRISHTINË

Totali I kontratave dhe referencave : 187,251.00 Euro

Vula dhe Nenshkrimi :

DITA TRAVEL PODUJEVË

Lista e referencave e Dita Travel: “transporti dhe akomodimi”, përfundimi 31.01.2025.

6. Kontratat “jashtë tabelës” nuk mund të llogariten (P-10, P-11)

Vendimi 6398 thotë se oferta “përmban kontrata dhe dëshmi edhe jashtë asaj tabele”, pa e emërtuar asnjërën. Kontratat e tjera në ofertë janë këto:

Kontrata	Pse nuk llogaritet
K.K. Skenderaj 643-24-10421 (87,340 €)	Referenca e menaxherit të kontratës, 15.10.2026: “kontrata është ende në fuqi” – në realizim e sipër (P-11)
Policia 214-24-10286	Nuk ka referencë të Policisë; figuron vetëm në listën e Joni Travel (P-10)
KEK 18-099 (përfunduar 30.12.2021)	Jashtë periudhës
K.K. Skenderaj 643-17-037 (25.05.2018)	Jashtë periudhës
KEK 22-6812 (28.02.2022)	Jashtë periudhës
MASHT 20-3492 (26.01.2023)	Jashtë periudhës
KEK 22-2410 (30.05.2022)	Jashtë periudhës
K.K. Skenderaj 643-20-5628 (30.06.2020)	Jashtë periudhës

Datat e përfundimit janë ato që i shënon vetë Joni Travel në listën e saj. Nëse AK ka llogaritur ndonjë prej tyre, ka shkelur Kërkesën 9 dhe nenin 59.4 të LPP. Nëse nuk i ka llogaritur, arsyetimi i saj nuk ka bazë.

PROVA P-11 – K.K. Skenderaj 643-24-10421: “kontrata është ende në fuqi”

Çka tregon: Referenca e datës 15.10.2026 thotë shprehimisht se kontrata është ende në fuqi dhe se shërbimet do të vazhdojnë deri në përfundim të kontratës.

Dispozita: Kërkesa 9 (“jo në realizim e sipër”) e FDT.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Komuna Skenderaj
Datë : 15.10.2026
Nr. i prot. 215 / 2026

Me kërkesën e Operatorit Ekonomik **Joni Travel SH.P.K –**, menagjeri i Kontratës lëshon këtë :

LETER REFERENCË

Operatori Ekonomik **Joni Travel SH.P.K**, për projektin me titull: **“Ofrimi i shërbimeve të nxënësve me nevoja të veçanta si dhe nxënësve për praktikën profesionale të shkollave të mesme të Komunës së Skenderajt” me nr. të prokurimit 643-24-10421-221**, ka lidhur kontratë më Komunën e Skenderajt përkatësisht me zyrën e Prokurimit më datë 27.11.2024, në vlerë të pergjithëshme të kontratës prej **92,925.00 (Nëntëdhjetëedymijeenëntëqindenjëzetepesë) euro.** Si menagjer i kontratës për këtë procedure të prokurimit deklaroj se OE në fjalë deri me tani ka kryer sherbimet në vlerë prej **87,340.00** Euro, sipas kontratës së nënshkruar, në afatet e parapara ligjore me korrektësi të plotë në punën ku theksoj se kontrata është ende në fuqi dhe sherbimet e transportit do te vazhdojnë të kryhen deri në perfundim të kontratës, prandaj unë si menagjer i kontratës dhe Autoriteti Kontraktues në këtë rast Komuna Skenderaj jemi të kënaqur më sherbimet e kryera nga OE **Joni Travel SH.P.K** dhe për këtë arsye leshoj referencë pozitive.

Menagjeri i Kontratës
Visar Shabani

Referenca e Komunës së Skenderajt e datës 15.10.2026.

7. Kontrata MASHT 22-2442-2-2-1 – 93,199.68 € (P-6)

Referenca e 24.04.2025 për këtë kontratë thotë se ajo është “e përmbushur para afatit të përfundimit të kontratës”, por nuk e jep datën e përfundimit. Edhe kjo referencë është nënshkruar nga “Udhëheqës i divizionit të prokurimit”, pra nga zyrtari të cilit neni 75.3, pika 1, i RrPP ia ndalon të nënshkruajë përfundimin e projektit. Megjithatë, edhe nëse kjo referencë pranohet, grupi arrin vetëm **211,747.68 €**, rreth një të tretën e pragut (shih Seksionin V).

8. Vendimi 6398 nuk është i arsyetuar (nenet 108/A.9 dhe 108/A.12 LPP) (P-13)

Ankuesi kontestoi çdo referencë veçmas, me numër, vlerë dhe arsye. AK u përgjigj me një paragraf të përgjithshëm: shuma 671,365.72 € “është totali i tetë kontratave të përzgjedhur nga ankuesi”. Vendimi nuk thotë asnjë fjalë për lëshuesin e vërtetimit të MASHT-it, për “Aktiv Shpk”, për referencat e Policisë gjatë realizimit, ose për mungesën e numrit dhe vlerës së kontratës te Don Bosko. Një refuzim pa përgjigje për pretendimet konkrete nuk është “i arsyetuar” sipas nenit 108/A të LPP.

PROVA P-13 – Vendimi i AK Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398), 13.11.2026 (Pjesa 3) – vendimi i kontestuar

Çka tregon: AK e refuzon Pretendimin 1 duke thënë se oferta e grupit "përmban kontrata dhe dëshmi edhe jashtë asaj tabele", pa i emërtuar ato. Për Pretendimet 2–6, AK nuk i mohon faktet (patentat e skaduara, mospërputhjen e vulave, nënshkrimin jashtë rubrikës), por i quan pa ndikim, dhe mbështetet në statutin e Dita Travel që nuk është në ofertë. AK nuk jep asnjë përgjigje për vërtetimin MASHT 25-6586, referencat e MKK-së për "Aktiv Shpk", referencat e Policisë gjatë realizimit dhe referencat e Don Bosko. Në hyrje vendimi e quan Pjesën 3 "Kazerma Prishtinë dhe Pomozatin", ndërsa në dispozitiv "Kazerma Mitrovicë dhe Istog".

Dispozita: Nenet 108/A.9 dhe 108/A.12 të LPP (vendim i arsyetuar); neni 59.4 i LPP; neni 7.1 i LPP.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO ODBRANE - MINISTRY OF DEFENSE
Nr.Prot: 6398 Nr. i Faqeve 4
Br.Prot: Br. Strana
No.Prot: No. of pages
Data: 13 / 11 / 2026
Datum:
Date:
Prishtinë / i.e.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Nr. 3-2/232/2026
Datë: 13.11.2026

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligji nr. 05/L -068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe nenit 8 të Rregullave për parashtrimin ankesave të miratuar nga KRPP-ja, sipas Kërkesës për Rishqyrtim, **me numër te protokolli 6398 të datës 11.11.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik ARDITI TOURS SH.P.K**për aktivitetin e prokurimit Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë: Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomozatin Nr. Prokurimi 217-26-8174-2-1-1 dhe Nr. i Brendshëm 217/26/094/211, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Autoritetit Kontraktues s - Ministria e Mbrojtjes, ka bërë rishqyrtimin e kërkesës të parashtruar nga Operatori Ekonomik dhe mori këtë:

VENDIM

I. **REFUZOHET** si e pa bazuar, kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik **ARDITI TOURS SH.P.Kpas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së** për projektin Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë: Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog Nr. Prokurimi 217-26-8174-2-1-1 dhe Nr. i Brendshëm 217/26/094/211, të shpallur nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes.

Vendimi 6398, faqja 1: emërtimi i Pjesës 3 në hyrje.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik **ARDITI TOURS SH.P.K** si palë e pakënaqur ka deponuar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të AK-MM me datë 11.11.2026, kundër njoftimit mbi vendimit të Autoritetit Kontraktues duke pretenduar se AK gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertës ka bërë shkelje të LPP-se, neneve në vijim:
Neni 1; i LPP-se, Qëllimi
Neni 7: i LPP-se, Barazia në trajtim /Jo Diskriminimi
Neni 10: i LPP-se, Mjetet e promovimit te transparences
Neni 27: i LPP-se, Dosja e tenderit
Neni 32: i LPP-se, Rregullat e përgjithshme
Neni 59: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
Neni 69: Aftësia teknike dhe profesionale.
Neni 72: i LPP-se, Dokumentacioni dhe informacionet shtese
Neni 108/A: Kërkesa për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.
Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi I Rregullores për Prokurim Publik
Neni 17 Dosja e Tenderit
Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
Neni 27 Kriteret e dhënies së kontratës
Neni 45 Procedurë e hapur

Përgjigje në pretendimet e Operatorit Ekonomik ARDITI TOURS SH.P.K
Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, komisioni i vlerësimit, në mënyrë të barabarte duke u thirrur dhe respektuar LPP-në nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Komisioni ka vepruar sipas LPP-se dhe kriteret e FTD-së.

Pretendimi Nr. 1 - Kërkesa 9 – Përvoja e grupit të rekomanduar
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. Shuma prej 671.365,72 € është totali i tetë kontratave të përzgjedhur nga ankuesi. Oferta e grupit Dita Travel–Ioni Travel përmban kontrata dhe dëshmi edhe jashtë asaj tabele. Përfundimi i ankuesit se përjashtimi i një kontrate të caktuar e zbret domosdoshmërisht grupin nën prag mbështetet në një premisë të pasaktë, sepse tabela e tij nuk përfshin tërësinë e dokumentacionit të ofertës.
Pretendimi për trajtim të pabarabartë nuk qëndron as sa i përket diferencës mbi prag. **Vetë ARDITI TOURS SH.P.K. e ka kaluar pragun me rreth 7.000 € dhe Komisioni ia ka llogaritur përvojën e pranuar**. I njëjti standard është zbatuar ndaj grupit të rekomanduar. Sipas nenit 7 të LPP-së, secili ofertues vlerësohet mbi dëshmitë e veta dhe kundrejt të njëjtit minimum. Dosja e Tenderit nuk parasheh asnjë kusht shtesë për ofertuesin që e kalon pragun me diferencë të ngushtë.

Pretendimi Nr. 2 Kërkesa 15 – Shoferët dhe menaxheri i projektit
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. **Ankuesi i mbështet kundërshtimet te disa patenta të veçanta, ndërsa kriteri vlerësohet mbi personelin e ofruar nga të dy anëtarët e grupit.** Grupi ka paraqitur dokumentacion për më shumë se dhjetë shoferë dhe Komisioni ka konstatuar se numri i shoferëve me kategori të vlefshme e tejkalon minimumin prej pesë. Edhe duke lënë jashtë numërimit patentat që ankuesi i konteston për skadim të kategorisë, dokumentacioni i ofertës përmban dëshmi për Mentor Rrahmanin, Basri Jasharin, Fejsal Isakun, Avni Ademin dhe Kujtim Halilin. Për këta pesë, kontrolli i anës së pasme të patentave tregon kategori D të vlefshme në datën e ofertimit. Kontrolli i kategorisë është bërë në rubrikën e saj të posaçme, ku

Vendimi 6398, faqja 2: arsyetimi për Pretendimin 1.

Komisioni ka vepruar sipas LPP-së dhe kriteret e PTD-së.

Pretendimi Nr. 1 - Kërkesa 9 – Përvoja e grupit të rekomanduar
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. Shuma prej 671.365,72 € është totali i tetë kontratave të përzgjedhur nga ankuesi. Oferta e grupit Dita Travel–Joni Travel përmban kontrata dhe dëshmi edhe jashtë asaj tabele. Përfundimi i ankuesit se përjashtimi i një kontrate të caktuar e zbret domosdoshmërish grupin nën prag mbështetet në një premisë të pasaktë, sepse tabela e tij nuk përfshin tërësinë e dokumentacionit të ofertës.
Pretendimi për trajtim të pabarabartë nuk qëndron as sa i përket diferencës mbi prag. **Vetë ARDITI TOURS SH.P.K. e ka kaluar pragun me rreth 7.000 € dhe Komisioni ia ka llogaritur përvojën e pranuar**. I njëjti standard është zbatuar ndaj grupit të rekomanduar. Sipas nenit 7 të LPP-së, secili ofertues vlerësohet mbi dëshmitë e veta dhe kundrejt të njëjtit minimum. Dosja e Tenderit nuk parasheh asnjë kusht shtesë për ofertuesin që e kalon pragun me diferencë të ngushtë.

Pretendimi Nr. 2 Kërkesa 15 – Shoferët dhe menaxheri i projektit
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. **Ankuesi i mbështet kundërshtimet te disa patenta të veçanta, ndërsa kriteri vlerësohet mbi personelin e ofruar nga të dy anëtarët e grupit.** Grupi ka paraqitur dokumentacion për më shumë se dhjetë shoferë dhe Komisioni ka konstatuar se numri i shoferëve me kategori të vlefshme e tejkalon minimumin prej pesë. Edhe duke lënë jashtë numërimit patentat që ankuesi i konteston për skadim të kategorisë, dokumentacioni i ofertës përmban dëshmi për Mentor Krahmanin, Basri Jasharin, Fejsal Isakun, Avni Ademin dhe Kujtim Halilin. Për këta pesë, kontrolli i anës së pasme të patentave tregon kategori D të vlefshme në datën e ofertimit. Kontrolli i kategorisë është bërë në rubrikën e saj të posaçme, ku

Vendimi 6398, faqja 2: AK pranon se numëron shoferët “duke lënë jashtë” patentat e skaduara.

shënohet afati për drejtimin e autobusit. Listat e stafit shqyrtohen së bashku me patentat dhe dokumentet individuale të angazhimit. Nenet 69 dhe 71 të LPP-së kërkojnë vlerësimin e aftësisë teknike të dëshmuar nga grupi. Vërejtja për formatin e një liste nuk rrëzon të dhënat që dokumentet shoqëruese i lidhin me shoferët e identifikuar në oferte.
Për menaxherin e Lotit 3, oferta përmban vendimin nr. 03/2026 të datës 19.10.2026, parakontratën për këtë lot dhe diplomën e Misim Vojvodës. Në listën e Dita Travel ai figuron si menaxher dhe është jashtë numërimit të pesë shoferëve të mësipërm. Parakontrata është formë dëshmie e lejuar nga Dosja e Tenderit. Aktivizimi i angazhimit me dhënien e kontratës përputhet me natyrën e atij dokumenti.

Pretendimi Nr. 3 Përfaqësimi dhe nënshkrimi i dokumenteve
Pretendimi për pavlefshmërinë e marrëveshjes së grupit refuzohet. Marrëveshja e 21.10.2026 identifikon aktivitetin me titullin, të katër lotet dhe numrin. Pika 3 autorizon shprehimisht Dita Travel, me përfaqësues Avdi Dilin, të veprojë në emër të grupit. Në faqen përfundimtare figurojnë nënshkrimet dhe vulat përkatëse pranë emrave të Avdi Dilit dhe Avni Ademit. Shifra shtesë në numrin e prokurimit dhe permendja e Hajdar Dilit në një paragraf nuk krijojnë paqartësi për aktivitetin, anëtarët e grupit ose personin e autorizuar sipas pikës 3. Pretendimi se regjistrimi i Avdi Dilit si drejtor menaxhues në ARBK e bën automatikisht të pavlefshëm çdo akt të nënshkruar nga Hajdar Dili **është i pabazuar**. Hajdar Dili figuron si aksionar i Dita Travel SH.P.K. dhe, në atë cilësi, ushtron kompetencat e vendimmarrjes që ia njeh ligji dhe statuti i shoqërisë. Prandaj, kompetenca për nxjerrjen e vendimit nr. 03/2026, të datës 19.10.2026, për emërimin e Misim Vojvodës si menaxher i projektit për Lotin 3, vlerësohet sipas ndarjes së kompetencave në shoqëri.

Pretendimi Nr. 4 Kërkesa 14 – Mjetet dhe disponimi i minibusit
Pretendimi se oferta nuk përmban dëshmi për minibusin e identifikuar refuzohet. Grupi ka paraqitur listën e mjeteve, dokumentacionin e autobusëve dhe kontratën e shfrytëzimit të minibusit. Në faqet 14–15 të dokumentit Lista e mjeteve dhe dokumentet gjendet kontrata e datës 19.10.2026 për minibusin Mercedes-Benz, 06-281-GG, me shasi WDB906657ES836565. Kontrata identifikon këtë aktivitet dhe e përfshin shprehimisht Lotin 3. Ajo përcakton vënien e mjetit në dispozicion për tender dhe kushtet e dorëzimit për realizimin e shërbimit.

Pretendimi Nr. 5 Aneksi 7, deklarata nën betim dhe licenca
Pretendimi për mungesë të marrëveshjes së vlefshme të grupit, të deklaratës së nënshkruar dhe të licencës në datën e ofertimit refuzohet. Marrëveshja e grupit. Aneksi 7 identifikon liderin, autorizimin për përfaqësim, pjesëmarrjen 80%–20% dhe përgjegjësinë e përbashkët dhe individuale të anëtarëve. Këto elemente janë të shprehura në marrëveshjen e nënshkruar dhe i përgjigjen kundërshtimit për mungesë të angazhimit të anëtarëve sipas nenit 71 të LPP-së. Komisioni ka vlerësuar dhe konstatuar se Marrëveshja i përmban pikat e nevojshme dhe si e tillë është e vlefshme dhe e pranueshme.
Deklarata nën betim. Deklarata e Joni Travel e datës 19.10.2026 identifikon Avni Ademin si drejtor dhe në dokument shihet nënshkrimi mbi vulën e shoqërisë. Fakti që nënshkrimi ndodhet mbi vulë dhe jashtë rubrikës së posaçme nuk e mbështet pretendimin se deklarata është e panënshkruar. Ky pretendim refuzohet i pabazuar.
Licenca – Pretendimi refuzohet si i pabazuar. Në datën e dorëzimit të ofertës, licencat e paraqitura nga grupi Dita Travel–Joni Travel kanë qenë të vlefshme. Sipas Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit, licencimi është kusht kontraktual që zbatohet ndaj operatorit të cilit i jepet kontrata. Dosja nuk e përcakton skadimin e mëvonshëm të licences së paraqitur si kriter eliminues në fazën e vlerësimit.

Vendimi 6398, faqja 3: lista e stafit si “format”; Hajdar Dili si “aksionar” sipas statutit; shifra shtesë; nënshkrimi “mbi vulë”; licenca si “kusht kontraktual”.



Operatori që kryen shërbimin ka detyrim të posedojë licencë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së ofrimit të tij. Nëse licenca e paraqitur skadon, operatori duhet ta rinovojë në kohë dhe mund ta paraqesë licencën e rinovuar gjatë zbatimit të kontratës, për verifikim nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi Nr. 6 Vulat në kontratën e minibusit 06-281-GG
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar certifikatën e regjistrimit të automjetit dhe kontratën e shfrytëzimit të datës **19.10.2026**. Në certifikatën e regjistrimit identifikohen minibusi me targë **06-281-GG**, numri i shasisë **WDB906657ES836565** dhe biznesi pronar **Baki Januzi B.I.** I njëjti biznes figuron si dhënës në shfrytëzim në kontratën e paraqitur, e cila është nënshkruar në emër të tij për të njëjtin automjet.
Komisioni i ka vlerësuar së bashku të dhënat e certifikatës së regjistrimit, identifikimin e palëve në kontratë dhe nënshkrimet e vendosura në të. Mospërputhja në vendosjen e vulave, e marrë më vete, nuk provon se kontrata nuk është nënshkruar në emër të biznesit pronar ose se mjeti nuk i është vënë në dispozicion Dita Travel SH.P.K. Për këto arsye, **Komisioni e ka pranuar kontratën si dëshmi të disponimit të minibusit për Lotin 3, në përputhje me Kërkesën 14 të Dosjes së Tenderit.**

Kërkesa për rishqyrtim e ARDITI TOURS SH.P.K. refuzohet në tërësi si e pabazuar. Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe tërësisë së dokumentacionit të ofertës, Autoriteti Kontraktues konstaton se grupi i rekomanduar i përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit për Lotin 3. Vlerësimi është kryer sipas kritereve të publikuara dhe duke zbatuar të njëjtin standard për të gjithë ofertuesit, në përputhje me nenet 7 dhe 59 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimet e ankuesit nuk dëshmojnë shkelje që cenon ligjshmërinë e vendimit të kontestuar. Rrjedhimisht, nuk ka bazë faktike apo juridike për eliminimin e grupit të rekomanduar, anulimin e vendimit ose kthimin e Lotit 3 në rivlerësim. Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Lotin 3 mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtës bazuar në konstatimet e cekura më lartë për aktivitetin e prokurimit Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë:
Pjesa 3 - Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog Nr. Prokurimi 217-

Vendimi 6398, faqja 4: AK pranon “mospërputhjen në vendosjen e vulave”; asnjë fjalë për vulën DALINA L.L.C.

9. Trajtim i pabarabartë (neni 7.1 LPP) (P-9, P-14)

AK shkruan se ka zbatuar “të njëjtin standard për të gjithë ofertuesit”. Faktet tregojnë të kundërtën:

- Ankuesit i është refuzuar referenca për kontratë në realizim (P-9), kurse grupit i janë pranuar referenca të Policisë të lëshuara në mes të kontratës.
- Në të njëjtën ditë, për Pjesën 1, AK e aprovoi pjesërisht pretendimin për një referencë të vetme dhe e ktheu Pjesën 1 në rivlerësim (Vendimi Nr. 3-2/231/2026, Nr. Prot. 6397). Për Pjesën 3, ku janë kontestuar gjashtë referenca me prova, AK i refuzoi të gjitha.

PROVA P-14 – Vendimi i AK Nr. 3-2/231/2026 (Nr. Prot. 6397), 13.11.2026 (Pjesa 1) – trajtim i ndryshëm i të njëjtit pretendim

Çka tregon: Në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin aktivitet, për Pjesën 1, AK e ka aprovuar pjesërisht pretendimin për referencën e kontestuar dhe e ka obliguar Komisionin "të bëj verifikimin e kontratës së kontestuar". Për Pjesën 3 nuk ka urdhëruar asnjë verifikim.

Dispozita: Neni 7.1 i LPP (trajtim i barabartë); neni 26.16 i RrPP.



e Mbrojtjes, ka bere rishqyrtimin e kerkeses te parashtruar nga Operatori Ekonomik dhe mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si pjesërisht bazuar, kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik **ARDITI TOURS SH.P.K pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së** për projektin Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë: Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomozatin Nr. Prokurimi 217-26-8174-2-1-1 dhe Nr. i Brendshëm 217/26/094/211, të shpallur nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Mbrojtjes.

II. ANULOHET, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministri e Mbrojtjes për projektin Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë: **Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomozatin** Nr. Prokurimi 217-26-8174-2-1-1 dhe Nr. i Brendshëm 217/26/094/211, datës 06.11.2026, **Pjesa 1 - kthehet në Rivlerësim.**

III. AUTORIZOHET Autoriteti Kontraktues/Ministria e Mbrojtjes, që të vazhdoj tutje me procedurën e prokurimit/rivlerësimin e ofertave sipas legjislacionit në fuqi.

IV. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues/Ministria e Mbrojtjes, vendimin për rishqyrtim të ja komunikoj parashtruesit të kërkesës dhe të gjitha palëve të interesuara.

Vendimi 6397, faqja 1: dispozitivi (APROVOHET, ANULOHET).

Neni 108/A: Kërkesa për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.
Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik
Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi I Rregullores për Prokurim Publik
Neni 17 Dosja e Tenderit
Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes
Neni 27 Kriteret e dhënies së kontratës
Neni 45 Procedurë e hapur

Përgjigje në pretendimet e Operatorit Ekonomik ARDITI TOURS SH.P.K

Pretendimi Nr. 1 - Kërkesa 09 (përvoja) e OE të Rekomanduar:
Pretendimi nga OE ankues aprovohet si pjesërisht i bazuar.
Komisioni i vlerësimit ka marrë për bazë referencën e OE nga Komuna e Prishtinës e cila është e nënshkruar dhe vulosur nga Komuna e Prishtinës e cila thekson se OE ka realizuar shërbimet e transportit publik në vlerë prej 695,355.61 Euro. Në fazën e rivlerësim, Komisioni obligohet të bëj verifikimin e kontratës së kontestuar dhe të jap rekomandimet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi Nr. 2 Kërkesa 08 – Qarkullimi
Pretendimi refuzohet si i pabazuar. Dosja e Tenderit e njeh raportin bankar si dëshmi për qarkullimin. Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin bankar të operatorit dhe ka vlerësuar se qarkullimi për vitet 2023–2025 e arrin minimumin e kërkuar prej 650.000,00 €. Për këtë arsye, mungesa e deklaratave tatimore nuk përbën mangësi kur kriteri dëshmohet nëpërmjet dokumentacionit bankar.
Përmendja e shumës së përgjithshme prej 812.512,27 €, e cila përfshin edhe një pjesë të vitit 2026, nuk provon se qarkullimi për vitet 2023–2025 bie nën prag. Po ashtu, krahasimi i hyrjeve në një llogari bankare me vlerat e deklaruara të kontratave, pa i harmonizuar periudhat dhe pagesat, nuk provon as mospërmbushjen e kriterit, as pasaktësinë e dëshmisë bankare.

Pretendimi Nr. 3 Informatat shtesë, pika 8 – Autorizimi për nënshkrim
Pretendimi aprovohet si pjesërisht i bazuar.
Komisioni ka marrë për bazë vendimin e datës 21.10.2026, me të cilin Kujtim Deliu është caktuar menaxher i kontratës. Ankuesi nxjerr përfundimin se dokumentet janë të pavlefshme vetëm nga fakti se Ali Deliu figuron në ekstraktin e ARBK-së si pronar dhe person i autorizuar.

2/3

Vendimi 6397, faqja 2: obligimi për verifikimin e kontratës së kontestuar.

10. Mangësitë nuk mund të plotësohen

Të gjitha mangësitë e mësipërme duken në vetë dokumentet e ofertës, prandaj nuk ka nevojë për verifikim. Sqarimet lejohen vetëm për dokumente ekzistenca e të cilave është e fiksuar para afatit (pika 28.1 IUT). Një tender jo i përgjegjshëm “nuk mund të bëhet i tillë … duke e korrigjuar” (pika 29.1 IUT), dhe AK nuk mund të pranojë “asnjë ndryshim material” (neni 59.2 LPP). Një referencë e re, e lëshuar nga një autoritet tjetër, për një operator tjetër ose me datë tjetër, do të ishte ndryshim material i ofertës.

11. Gabim në identifikimin e Pjesës

Në hyrje, Vendimi 6398 e quan Pjesën 3 “Kazerma Prishtinë dhe Pomozatin”, ndërsa në dispozitiv “Kazerma Mitrovicë dhe Istog” (P-13). Kjo tregon se kërkesa nuk është shqyrtuar me kujdesin që kërkon neni 108/A i LPP.

IV.B Faktet dhe arsyetimi juridik – Pretendimet 2 deri 6

12. Pretendimi 2 – Stafi dhe shoferët (Kërkesa 15) (P-15, P-16, P-13)

- Evidenca 15 a) kërkon listën e punëtorëve, “e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin, përvojën e punës (vite) dhe pozitën në kompani”. Lista e Dita Travel ka vetëm

emrin, numrin personal dhe pozicionin (P-15). AK e quan këtë “vërejtje për formatin e një liste” (P-13, faqja 3). Profesioni dhe përvoja nuk janë format, por përmbajtje e kërkuar nga Dosja. Oferta që nuk i përmban nuk është e përgjegjshme (neni 59.4 LPP; pika 27.2 IUT).

- Në ofertë janë paraqitur shoferë me kategori D të skaduar në ditën e ofertimit, 21.10.2026: Avdi Dili (07.06.2025), Ruzhdi Dili (18.04.2026), Agim Vojvoda (29.06.2025), Nuradin Ahmeti (30.09.2026) (P-16).
- AK nuk e mohon se këto patenta kanë kategorinë D të skaduar. Ajo vetëm shkruan se, “Edhe duke lënë jashtë numërimit patentat që ankuesi i konteston për skadim të kategorisë”, mbeten pesë shoferë me kategori të vlefshme (P-13, faqja 2). Megjithatë, Evidenca 15 a) kërkon që lista të shoqërohet me “lejet e vozitjes me kategoritë përkatëse për automjetin e caktuar”. Një listë që paraqet si shoferë persona me kategori D të skaduar përmban të dhëna të pasakta dhe nuk plotëson Evidencën 15 a).

PROVA P-15 – Lista e stafit e Dita Travel: pa profesion dhe pa përvojë pune

Çka tregon: Lista ka vetëm emrin dhe mbiemrin, numrin personal dhe pozicionin. Mungojnë profesioni dhe përvoja e punës në vite.

Dispozita: Evidenca 15 a) e FDT; pika 27.2 e IUT.

DITA
KOMPANIA TURISTIKE

LISTA E STAFIT

EMRI DHE MBIEMRI	NR.PERSONAL	POZICIONI
MENTOR RRAHMANI	1014845875	SHOFER
BASRI JASHARI	1005743458	SHOFER
AVDI DILI	1010735218	SHOFER
FEJSAL ISAKU	1030723852	SHOFER
RUZHDI DILI	1010735994	SHOFER
MISIM VOJVODA	1021299118	MENAXHER

KOMPANIA TURISTIKE DITA

DITA TRAVEL PODUJEVË

Lista e stafit e Dita Travel.

PROVA P-16 – Patentë-shoferët me kategori D të skaduar në ditën e ofertimit (21.10.2026)

Çka tregon: Avdi Dili: kategoria D deri më 07.06.2025. Ruzhdi Dili: deri më 18.04.2026. Agim Vojvoda: deri më 29.06.2025. Nuradin Ahmeti: deri më 30.09.2026 (kolona 11 në anën e pasme të patentës).

Dispozita: Kërkesa 15 dhe Evidenca 15 a) e FDT; Aneksi 1 i DT.



Avdi Dili – ana e parme.



Avdi Dili – ana e pasme: D deri më 07.06.25.



Ruzhdi Dili – ana e parme.



13.	9.	10.	11.	12.
	AM	- - -	- - -	- - -
14.	A1	- - -	- - -	- - -
	A2	- - -	- - -	- - -
	A	- - -	- - -	- - -
	B1	08.12.10	18.04.31	- - -
	B	21.10.02	18.04.31	- - -
	C1	21.10.02	18.04.26	- - -
	C	21.10.02	18.04.26	- - -
	D1	08.10.08	18.04.26	- - -
	D	08.10.08	18.04.26	- - -
	BE	21.10.02	18.04.31	- - -
	C1E	21.10.02	18.04.26	- - -
	CE	21.10.02	18.04.26	- - -
	D1E	19.04.21	18.04.26	- - -
	DE	19.04.21	18.04.26	- - -
	M	08.12.10	- - -	- - -
	L	08.12.10	- - -	- - -
	T	08.12.10	- - -	- - -
12.				

Scanned with CamScanner

Ruzhdi Dili – ana e pasme: D deri më 18.04.26.



Agim Vojvoda – të dy anët.





Nuradin Ahmeti – të dy anët: D deri më 30.09.26.

13. Pretendimi 3 – Nënshkruesi dhe marrëveshja e grupit (P-17, P-18, P-19, P-13)

- Sipas ekstraktit të ARBK-së të dorëzuar në ofertë, personi i vetëm i autorizuar i Dita Travel është Avdi Dili, “Drejtor menaxhues”; Hajdar Dili figuron vetëm si pronar (P-17).

- Vendimi nr. 03/2026 për menaxherin e Pjesës 3 dhe kontrata e qirasë së minibusit janë nënshkruar nga Hajdar Dili me cilësimin “Drejtor” (P-18, P-20). Në ofertë nuk ka autorizim për të (pika 8 e Informatave shtesë të FDT).
- AK e arsyeton këtë me “kompetencat … që ia njeh ligji dhe statuti i shoqërisë” (P-13, faqja 3). Statuti nuk është pjesë e ofertës. AK ka vlerësuar mbi bazën e një dokumenti që nuk është dorëzuar, në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP dhe pikën 28.1 të IUT. Përveç kësaj, Hajdar Dili ka nënshkruar si “Drejtor”, jo si aksionar.
- Marrëveshja e grupit (Aneksi 7) e shënon numrin e prokurimit “217-26-8174-2-1-11” (P-19). AK nuk e mohon këtë; ajo shkruan se “Shifra shtesë në numrin e prokurimit dhe përmendja e Hajdar Dilit në një paragraf nuk krijojnë paqartësi” (P-13, faqja 3).

PROVA P-17 – ARBK: personi i vetëm i autorizuar i Dita Travel është Avdi Dili

Çka tregon: Sipas ekstraktit të ARBK-së të dorëzuar në ofertë, person i autorizuar është Avdi Dili, “Drejtor menaxhues”. Hajdar Dili figuron vetëm si pronar.

Dispozita: Pika 8 e Informatave shtesë të FDT (autorizimi për nënshkrim).



AGJENSIONI I REGJISTRIMIT TË BIZNEVE NË KOSOVË
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

Informata mbi biznesin
Information about business
Informacija o biznisu

Person fizik

Emri: **Name:** **Ime:**	Avdi Dili
ID Personale: **Personal ID:** **Licni ID:**	1010735218
Adresa: **Address:** **Adresa:**	Batllavë Batllavë Podujevë, Kosova
Përgjegjësia: **Liability:** **Odgovornost:**	
Pjesa në pronë: **Owned part:** **Deo o vlasnistvu:**	3,000.00€
Data lindjes: **Birthdate:** **Datum rođenja:**	15/07/1982

[X] Aksionar / Shareholder / Akcionarsko [ ] Aksionar i privilegjuar / Privileged shareholder/ Privilegovani akcionar

Personat e autorizuar / Authorized participants / Ovlascene lice

Emri: **Name:** **Ime:**	Avdi Dili
ID Personale: **Personal ID:** **Licni ID:**	1010735218
Pozita e punës: **Job position:** **Radno mesto:**	Drejtor menaxhues
Adresa: **Address:** **Adresa:**	Batllavë Batllavë Podujevë, Kosova
Autorizimet: **Authorizations:** **Autorizacije:**	Sipas ligjit dhe statutit.

Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" p.n, Lagjja e Spitalit 10000 Prishtinë
Data / Date / Datum: **12/09/2025 08:01**
Tel1: 038 200 36 562
Tel2: 038 200 36 573
Faqe 6 nga 6

Ekstrakti i ARBK-së për Dita Travel, faqja e personave të autorizuar.

PROVA P-18 – Vendimi për menaxherin e Pjesës 3, i nënshkruar nga Hajdar Dili si “Drejtor”

Çka tregon: Vendimi për emërimin e menaxherit të projektit për Pjesën 3 është nënshkruar nga Hajdar Dili me cilësimin “Drejtor”. Në ofertë nuk ka autorizim për nënshkrim.

Dispozita: Evidenca 15 b) e FDT; pika 8 e Informatave shtesë të FDT.

DITA TRAVEL sh.p.k

Nr. i biznesit: 811944132
Selia: Batllavë – Podujevë

Nr. i vendimit: 03/2026
Prishtinë, më 19.10.2026

Vendim për emërimin e menaxherit të projektit

Pjesa 3 Loti 3

Drejtori i Dita Travel sh.p.k, z. Hajdar Dili, për organizimin dhe menaxhimin e realizimit të shërbimeve në procedurën e prokurimit të përcaktuar më poshtë, nxjerr këtë vendim:

1 Emërimi
Z. Misim Vojvoda, me numër personal 1021299118, emërohet menaxher i projektit për Pjesën 3 (Lotin 3) të kontratës së shërbimeve të transportit të pjesëtarëve të FSK-së.

2 Kontrata dhe pjesa përkatëse
Titulli i kontratës: Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë.
Numri i prokurimit: 217-26-8174-2-1-1.
Pjesa për të cilën bëhet emërimi: Pjesa 3 (Loti 3) – Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog.

3 Detyrat e menaxherit të projektit
Menaxheri i projektit koordinon organizimin dhe realizimin e shërbimeve të Lotit 3, përcjell respektimin e orareve dhe kërkesave të këtij loti, bashkërendon punën me personelin e angazhuar dhe mban komunikimin për zbatimin e shërbimeve me përfaqësuesit përkatës të autoritetit kontraktues. Ai përcjell dokumentacionin e realizimit, raporton te drejtori për ecurinë dhe çdo pengesë dhe ndërmerr veprimet organizative brenda detyrave dhe autorizimeve të tij, sipas dosjes së tenderit dhe kontratës përkatëse.

4 Fusha dhe periudha e emërimit
Ky vendim vlen vetëm për Lotin 3, për kazermat Mitrovicë dhe Istog. Emërimi paraqitet në ofertën e Dita Travel sh.p.k për këtë lot. Në rast të dhënies dhe lidhjes së kontratës për këtë lot me Dita Travel sh.p.k, menaxheri ushtron detyrat gjatë realizimit dhe deri në përfundimin e shërbimeve të lotit përkatës.

5 Hyrja në fuqi
Ky vendim hyn në fuqi në datën e nxjerrjes dhe i dorëzohet të emëruarit, përfshihet në dosjen e ofertës për lotin përkatës dhe ruhet në arkivin e kompanisë.

Për Dita Travel sh.p.k
Hajdar Dili
Drejtor

Nënshkrimi: _____

Vula e kompanisë

DITA TRAVEL
PODUJEVË

Vendimi për Pjesën 3, i datës 19.10.2026.

PROVA P-19 – Marrëveshja e grupit (Aneksi 7): numër i gabuar i prokurimit

Çka tregon: Numri i prokurimit është shënuar “217-26-8174-2-1-11” në vend të 217-26-8174-2-1-1.
Dispozita: Aneksi 7 i DT; neni 26.15 i RrPP.

Aneksi 7 DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupi/apo konzorciumi që aplikon

Për: MINISTRIA E MBROJTJES]
(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [*1. **DITA TRAVEL SHPK** , me seli në Podujev, me numër të regjistrimit të biznesit 811944132, e përfaqësuar nga z. Avdi DILI , dhe Kompanisë “**Joni TRAVEL” SH.P.K** Skenderaj me numër të regjistrimit të biznesit 811014779, e përfaqësuar nga z. Avni ADEMI dhe*]
(në vazhdim “tenderuesi”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: [*Titulli: Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë*

Numri i Prokurimit: [*217-26-8174-2-1-11*] Nr i brendshëm217/26/094/211

Hyjnë ne bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: [*Titulli: Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë*

Pjesa 1 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomazotin

Pjesa 2 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjilan dhe Ferizaj.

Pjesa 3 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Mitrovicë dhe Istog

Pjesa 4 Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjakovë dhe Suharekë Numri i Prokurimit: [217-26-8174-2-1-11] Nr i brendshëm217/26/094/211

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

I. ___ **DITA TRAVEL SHPK , me seli në Podujev, me numër të regjistrimit të biznesit 811944132, e përfaqësuar nga z. Hajdar DILI,_____**
Shëno emrin LIDER

Dhe

I. **___. Kompanisë “Joni TRAVEL” SH.P.K Skenderaj me numër të regjistrimit të biznesit 811014779, e përfaqësuar nga z. Avni ADEMI _____**
Shëno emrin e anëtarit të grupit -Antar ***Shëno adresën***

shto sipas nevojës .....

Datë: _21.10.2026___

Vendi: _____PRISHTINE_____

Marrëveshja e grupit, faqja 1.

14. Pretendimet 4 dhe 6 – Minibusi 06-281-GG dhe vulat (P-20, P-13)

- Evidenca 14 a) kërkon kontrata të qirasë “të nënshkruara nga të dy palët”.

- Dhënësi në shfrytëzim është Baki Januzi B.I. (nr. i biznesit 80023863, Kamenicë). Te nënshkrimi i tij është vula e DITA TRAVEL SH.P.K., d.m.th. e marrësit. Vula e Baki Januzi B.I. mungon (P-20).
- Te nënshkrimi i marrësit, Dita Travel sh.p.k. (Hajdar Dili – Drejtor), është vula "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR – NIPT – DALINA L.L.C. – TIRANË – ALBANIA". Kjo është vulë e një shoqërie të regjistruar në Shqipëri (NIPT është numri tatimor në Shqipëri), e cila nuk është palë në kontratë (P-20).
- AK nuk e mohon mospërputhjen e vulave; ajo shkruan se "Mospërputhja në vendosjen e vulave, e marrë më vete, nuk provon se kontrata nuk është nënshkruar në emër të biznesit pronar" (P-13, faqja 4). Vulën e DALINA L.L.C. AK nuk e përmend fare. Një kontratë ku asnjë vulë nuk i përket palës që e ka vendosur nuk dëshmon se është nënshkruar nga të dy palët. Kontrata nuk plotëson Evidencën 14 a) dhe nenin 59.4 të LPP.

PROVA P-20 – Kontrata e qirasë së minibusit: vula e Dita te pronari dhe vula e një shoqërie nga Shqipëria te marrësi

Çka tregon: Dhënës në shfrytëzim është Baki Januzi B.I. (nr. i biznesit 80023863, Kamenicë); te nënshkrimi i tij është vula e DITA TRAVEL SH.P.K. Te nënshkrimi i marrësit (Dita Travel sh.p.k., Hajdar Dili – Drejtor) është vula "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar – NIPT – DALINA L.L.C. – Tiranë – Albania", pra vula e një shoqërie të regjistruar në Shqipëri (NIPT është numri tatimor i Shqipërisë). Kjo shoqëri nuk është palë në kontratë, as dhënësi as marrësi. Vula e dhënësit Baki Januzi B.I. mungon.

Dispozita: Evidenca 14 a) e FDT ("të nënshkruara nga të dy palët").

DITA
KOMPANIA TURISTIKE

Kontratë për dhënien e minibusit në shfrytëzim

Lidhur në Prishtinë, më 19.10.2026

DHËNËSI NË SHFRYTËZIM	MARRËSI NË SHFRYTËZIM
Baki Januzi B.I.	Dita Travel sh.p.k
Nr. i biznesit: 80023863	Nr. i biznesit: 811944132
Adresa: Kamenicë	Selia: Batllavë – Podujevë
Përfaqësuar nga Baki Januzi, Pronar	Përfaqësuar nga Hajdar Dili, Drejtor
Në vijim: Dhënësi	Në vijim: Marrësi

Neni 1 Objekti i kontratës
Dhënësi i jep Marrësit në shfrytëzim me pagesë minibusin me targë regjistrimi 06-281-GG dhe numër shasie WDB906657ES836565. Marrësi e pranon minibusin për nevojat e realizimit të shërbimeve të transportit në tenderin e përcaktuar në Nenin 2. Pronësia mbi minibusin mbetet te Dhënësi.

Neni 2 Tenderi dhe lotet e përfshira
Minibusi vihet në dispozicion të Dita Travel sh.p.k për tenderin me titull "Shërbimet e transportit të pjesëtarëve të FSK-së e ndarë në 4 Pjesë", me numër prokurimi 217-26-8174-2-1-1, për të gjitha pjesët si vijon:
Pjesa 1 – Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Prishtinë dhe Pomazotin.
Pjesa 2 – Shërbimet e transportit të pjesëtarëve Kazerma Gjilan dhe Ferizaj.

Kontrata e datës 19.10.2026: palët.

Çdo ndryshim i kësaj kontrate bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët. Kontrata përfundon me mbarimin e periudhës së përcaktuar në Nenin 3 ose më herët me marrëveshje të shkruar të palëve. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, pala e prekur e njofton me shkrim palën tjetër dhe kërkon përmbushjen ose zgjidhjen e kontratës sipas kushteve të saj dhe legjislacionit të zbatueshëm. Detyrimet e pagesës të krijuara deri në përfundim mbeten për t'u shlyer.

Neni 10 Dispozitat përfundimtare
Palët përpiqen t'i zgjidhin mosmarrëveshjet me marrëveshje; në mungesë të saj, çështja i paraqitet organit kompetent sipas legjislacionit të zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Kontrata hartohet në dy ekzemplarë të njëjtë, nga një për secilën palë. Palët deklarojnë se e kanë lexuar dhe pranojnë përmbajtjen e saj.

DHËNËSI NË SHFRYTËZIM	MARRËSI NË SHFRYTËZIM
Baki Januzi B.I.	Dita Travel sh.p.k
Baki Januzi – Pronar	Hajdar Dili – Drejtor
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:
Vula	Vula

SH.P.K. DITA TRAVEL PODUJEVË

NIPT DALINA L.L.C. TIRANË - ALBANIA

Kontrata: nënshkrimet dhe vulat.



Zmadhim: vula e DALINA L.L.C., NIPT, Tiranë – Albania, në fushën e marrësit Dita Travel sh.p.k.

15. Pretendimi 5 – Deklarata nën betim dhe licenca e Joni Travel (P-21, P-22, P-13)

- Në Deklaratën nën betim të Joni Travel (Aneksi 2), fusha “Nënshkrimi” është bosh; në fushën “Vula” është futur imazhi i vulës me nënshkrim (P-21). AK e pranon se nënshkrimi është “mbi vulë dhe jashtë rubrikës së posaçme” (P-13, faqja 3). Evidenca 01 dhe Aneksi 2 i Dosjes kërkojnë deklaratë të nënshkruar në rubrikën përkatëse (pika 27.2 IUT).
- Licenca e Joni Travel nr. 049/21 që gjendet në ofertë vlen nga 16.11.2021 deri më 15.11.2026 (P-22). Ajo ka skaduar dy ditë pas vendimit të AK-së dhe para nënshkrimit të kontratës. AK pranon se licencimi është “kusht kontraktual që zbatohet ndaj operatorit të cilit i jepet kontrata” (P-13, faqja 3). Oferta nuk përmban licencë të vlefshme të anëtarit të grupit për periudhën e kontratës.

PROVA P-21 – Deklarata nën betim e Joni Travel (Aneksi 2): fusha “Nënshkrimi” bosh

Çka tregon: Fusha e nënshkrimit është bosh; në fushën “Vula” është futur imazhi i vulës me nënshkrim.
Dispozita: Evidenca 01 e FDT; neni 17.9 i RrPP.

Adresa e plotë:	SKENDERAJ
I përfaqësuar nga:	
Emri	AVNI ADEMI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	19.10.2026
Vula	



B28_Ng Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë – Shërbim Me Disa OE

Deklarata nën betim e Joni Travel, e datës 19.10.2026.

PROVA P-22 – Licenca e Joni Travel skadon më 15.11.2026

Çka tregon: Licenca nr. 049/21 për transport brenda Kosovës vlen nga 16.11.2021 deri më 15.11.2026, pra para nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të shërbimit.

Dispozita: Aneksi 1 i DT (licencimi i OE që shpërblehet me kontratë).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Mjedisit ,Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment , Spatial Planning and Infrastructure

Në mbështetje të Ligjit / Na osnovu zakona / Pursuant to Law / Nr.04/L-179
Ministri i MMPHI-së lëshon këtë / Ministar MZSPPI /izdaje ovu / Minister of MESPI issued this :

Licencë - Licencu

Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të rregullt të udhëtarëve me autobus dhe transport të lirë brenda Kosovës
Za obavljanje redovnog prevoza putnika autobusem i slobodnog prevoza na unutrasnjem transportu Kosovo

Operatori / Prevoznik: **JONI TRAVEL SH.P.K.**
Adresa / Adresa: **Azem Bejta**
Komuna / Opština: **Skenderaj**
Nr. i Licensës / Br. Licence: **049/21**
Nr. i Biznesit / Br.Biznisa: **811014779**
Licenca vlen prej / Licenca važi od/do **16.11.2021** deri më **15.11.2026**
Lëshuar më /Izdato: **02.09.2021**

zv. Ministri/zm.Ministar/dm Minister
Hysen DURMISHI

Licenca e Joni Travel nr. 049/21.

16. AK nuk ka zbatuar “të njëjtin standard”

Për Pretendimet 2–6 vlen e njëjta gjë si në pikën 9: në Vendimin 6397 për Pjesën 1, AK e pranoi pjesërisht edhe pretendimin për autorizimin e nënshkruesit dhe e ktheu Pjesën 1 në rivlerësim (P-14). Për Pjesën 3, ku AK nuk i mohon faktet (patentat e skaduara, mospërputhjen e vulave, nënshkrimin jashtë rubrikës), i refuzoi të gjitha (neni 7.1 LPP).

V. Llogaritja e referencave

Pas heqjes së referencave të pavlefshme, grupi ka dëshmuar **211,747.68 €** përvojë (ose 118,548.00 € pa MASHT 22-2442). Kjo është **438,252.32 € më pak** se pragu prej 650,000.00 €. Shumat janë vlerat e shënuara në vetë referencat (P-3 deri P-12).

Anëtari	Kontrata / referenca	Vlera (€)	Statusi	Prova
Joni	K.K. Skenderaj 643-22-9103	88,280.00	E pakontestuar	–
Dita	MPB 214-22-11730	16,000.00	E pakontestuar	–
Dita	MKK-211/22/008/221	14,268.00	E pakontestuar	–
Joni	MASHT 22-2442	93,199.68	Pa datë përfundimi (llogaritet në favor të grupit)	P-6

Anëtari	Kontrata / referenca	Vlera (€)	Statusi	Prova
Joni	MASHT 25-6586	63,751.00	Nuk e ka lëshuar MASHT; 36 muaj kundrejt 12	P-5
Dita	MKK-211/23/020/221	13,452.00	Vërteton “Aktiv Shpk”	P-3
Dita	MKK-211/24/018/221	13,920.00	Vërteton “Aktiv Shpk”; lëshuar para përfundimit	P-4
Dita	Don Bosko 2023, 2024, 2025	129,611.00	Pa numër dhe vlerë kontrate; transport me akomodim	P-12
Joni	Policia 214-23-10338	119,837.44	Në realizim; pa dëshmi përfundimi	P-7, P-9
Joni	Policia 214-24-5575	119,046.60	Në realizim deri më 25.06.2027	P-8, P-9
	Gjithsej, nëse pranohet çdo referencë	**671,365.72**	21,365.72 € mbi prag	

Referenca	Vlera (€)	Pse nuk vlen
MASHT 25-6586	63,751.00	Nuk e ka lëshuar MASHT; 36 muaj kundrejt 12
MKK-211/23/020/221	13,452.00	Vërteton “Aktiv Shpk”
MKK-211/24/018/221	13,920.00	Vërteton “Aktiv Shpk”; lëshuar para përfundimit
Don Bosko (3 referenca)	129,611.00	Pa numër e vlerë kontrate; periudhë jashtë afatit; transport me akomodim
Policia 214-23-10338	119,837.44	Në realizim më 24.09.2026; referencë në mes të kontratës
Policia 214-24-5575	119,046.60	Në fuqi deri më 25.06.2027
Gjithsej e pavlefshme	**459,618.04**	

671,365.72 − 459,618.04 = **211,747.68 €**, nën pragun prej 650,000.00 €. Mjafton që të mos llogaritet vetëm një prej grupeve të mësipërme (MASHT 25, Don Bosko ose Policia) që grupi të bjerë nën prag, sepse diferenca mbi prag ishte vetëm 21,365.72 €. Edhe me pragun e Pjesës 3 (625,000.00 €), heqja vetëm e vërtetimit MASHT 25-6586 e çon grupin në 607,614.72 €, nën prag. Oferta e grupit nuk është e përgjegjshme sipas nenit 59.4 të LPP.

VI. Kërkesa drejtuar OSHP-së

Bazuar në sa u tha më lart, ankuesi i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së:

1. Të aprovojë ankesën e ARDITI TOURS SH.P.K. si të bazuar.
2. Të konstatojë se këto referenca **nuk janë të vlefshme** dhe nuk mund të llogariten sipas Kërkesës 9 dhe Evidencës 9 të Dosjes së Tenderit, nenit 69.4.2 të LPP dhe neneve 25.13 e 25.16 të RrPP: vërtetimi për MASHT 25-6586 (63,751.00 €); referencat e MKK-së MKK-211/23/020/221 dhe MKK-211/24/018/221 (27,372.00 €); referencat e Policisë së Kosovës 214-23-10338 dhe 214-24-5575 (238,884.04 €); dhe referencat e Don Bosko (129,611.00 €).
3. Të konstatojë se grupi DITA TRAVEL – JONI TRAVEL ka dëshmuar më së shumti 211,747.68 € përvojë të pranueshme, nën pragun prej 650,000.00 €, dhe se oferta e tij për Pjesën 3 nuk është e përgjegjshme sipas nenit 59.4 të LPP; si dhe se oferta nuk plotëson Kërkesat 14 dhe 15 dhe Aneksët 1, 2 dhe 7 të Dosjes së Tenderit (Pretendimet 2–6).
4. Të anulojë në tërësi Vendimin e AK Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398) të datës 13.11.2026 dhe Njoftimin për dhënie të kontratës të datës 06.11.2026 për Pjesën 3 – Kazerma Mitrovicë dhe

Istog (neni 105.2.8 LPP).

5. Ta urdhërojë AK-në, sipas nenit 105.2.10 të LPP, që ta refuzojë ofertën e grupit si të papërgjegjshme, pa i kërkuar ose pranuar dokumente të reja (neni 59.2 LPP; pikat 28.1 dhe 29.1 IUT), dhe ta rivlerësojë Pjesën 3 vetëm me ofertat e mbetura.

6. Ta urdhërojë AK-në të veprojë sipas nenit 26.14 të RrPP për të dhënat në listën e kontratave të Joni Travel, të cilat bien ndesh me kontratat dhe referencat e Policisë së Kosovës.

7. Të urdhërojë kthimin e tarifës së ankesës te ankuesi, sipas nenit 118.3 të LPP.

Sipas nenit 112 të LPP, parashtrimi i kësaj ankese e pezullon automatikisht aktivitetin e prokurimit për Pjesën 3, pavarësisht nga pika III e Vendimit 6398, me të cilën AK është autorizuar "që të vazhdoj tutje me procedurën e prokurimit". Deri në vendimin përfundimtar të OSHP-së, ankuesi kërkon që kontrata për Pjesën 3 të mos nënshkruhet (neni 105.2.6 LPP).

VII. Provat dhe shtojcat

Provat P-1 deri P-22 janë bashkëngjitur menjëherë pas pikës së ankesës ku përmenden, me pjesët përkatëse të shënuara me kornizë të kuqe:

Prova	Përmbajtja
P-1	Dosja e Tenderit – Kërkesa 09 dhe Evidenca 09
P-2	Formulari i tenderit i grupit – oferta për të katër Pjesët
P-3	MKK-211/23/020/221 – kontrata me Dita Travel dhe referenca për "Aktiv Shpk"
P-4	MKK-211/24/018/221 – referenca e 11.12.2025 dhe pika 6.4 (përfundimi 20.12.2025)
P-5	MASHT 25-6586-2-2-1 – vërtetimi i 15.10.2026 dhe kontrata (neni 1.4, nënshkruesi)
P-6	MASHT 22-2442-2-2-1 – referenca e lëshuar nga MASHT
P-7	Policia 214-23-10338 – referenca e 28.04.2025 dhe neni 1.4
P-8	Policia 214-24-5575 – referenca e 28.04.2025 dhe neni 1.4
P-9	Emaili i Ministrisë së Mbrojtjes, 25.08.2026
P-10	Listat e kontratave të Joni Travel (dy versione)
P-11	K.K. Skenderaj 643-24-10421 – "ende në fuqi"
P-12	Don Bosko – referencat, marrëveshja, pagesat, lista e Dita Travel
P-13	Vendimi i AK Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398), 13.11.2026 (Pjesa 3), me pasazhet e kontestuara të shënuara
P-14	Vendimi i AK Nr. 3-2/231/2026 (Nr. Prot. 6397), 13.11.2026 (Pjesa 1)
P-15	Lista e stafit e Dita Travel – pa profesion dhe përvojë
P-16	Patentat me kategori D të skaduar (Avdi Dili, Ruzhdi Dili, Agim Vojvoda, Nuradin Ahmeti)
P-17	Ekstrakti i ARBK-së për Dita Travel – personi i autorizuar
P-18	Vendimi nr. 03/2026 për menaxherin e Pjesës 3, nënshkruar nga Hajdar Dili "Drejtor"
P-19	Marrëveshja e grupit (Aneksi 7) – numri "217-26-8174-2-1-11"
P-20	Kontrata e qirasë së minibusit 06-281-GG – vula e Dita te dhënësi, vula DALINA L.L.C. (Tiranë) te marrësi
P-21	Deklarata nën betim e Joni Travel – fusha "Nënshkrimi" bosh
P-22	Licenca e Joni Travel nr. 049/21 – skadon më 15.11.2026

Shtojca të tjera:

- Kopja e plotë e Vendimit të AK Nr. 3-2/232/2026 (Nr. Prot. 6398), 13.11.2026
- Kopja e Njoftimit për dhënie të kontratës, 06.11.2026 (neni 111.1.4 LPP)
- Kërkesa për rishqyrtim e ankuesit, 11.11.2026
- Dëshmia e pagesës së tarifës së ankesës: 6,250.00 € (1% e vlerës së parashikuar të Pjesës 3, 625,000.00 €)
- Certifikata e biznesit e ankuesit dhe autorizimi i përfaqësuesit
- Dëshmia e dërgimit të kopjes së ankesës AK-së (neni 111.2 LPP)

Vendi dhe data: Ferizaj, ____.11.2026

Për ankuesin – ARDITI TOURS SH.P.K.

Albert Fazlija, përfaqësues

Nënshkrimi: _____ Vula: _____

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ARDITI TOURS FERIZAJ